

NATURAL
POOL&SPA



@NATURAL POOL&SPA



WWW.NATURAL-KS.COM



+38348473473



SOJEVË, FERIZAJ

TRAVEL MAGAZINE

PRILL - MAJ 2025

GP MAGAZINE

AIRPLANE MAGAZINE

Esploro
Parisin

PRIZRENI,
qyteti që ruan
historinë

**FERIDE
RUSHITI,**
Aktivistja e drejtave
të njeriut e nominuar
për Çmimin
Nobel për Paqe

TË RINJTË E
Kosovës jetojnë
me prindërit

GP AVIATION,
ME REKORD LIDHJESH
NGA PRISHTINA
DREJT BOTËS

REPORTING
HOUSE

HYRJA FALAS

VIZITONI MUZEUN
"REPORTING HOUSE"

E MARTË - E SHTUNË | 10:00"-18:00"

LOKACIONI: ISH-SHTËPIA E MALLRAVE GËRMIA, TE SKËNDERBEU



KJO OFERTË VLEN VETËM PËR UDHËTARËT E GP AVIATION

1 GB FALAS eSIM
PËR KOSOVË, SERBI, BALLKAN DHE KREJT EUROPE

4G/5G AKTIVIZIM I MENJËHERSHËM

SKANO QR CODE DHE
MERR OFERTËN

thirr.com/gp



REKLAMO BIZNESIN NË AEROPLAN

 www.pfp-ks.com

NA KONTAKTONI:

 info@pfp-marketing.com

 +383 43 899 331



TRENDI MODERN I HOTELERISË

Mirësevini në Bonita Luxury Resort!

Një oaz luksi në Golem, Bonita ofron pushime të paharrueshme me AQUA PARK-un unik, katër pishina dhe plazhin rënor me shërbime të shkëlqyera në beach bar.

Relaks dhe argëtim në një ambient modern dhe tërheqës!

-  Akomodime luksoze
-  Kuzhinë e klasit botëror
-  Relaksohuni dhe rigjallërohuni

Kontakt:



+355 69 559 9916



www.hotelbonita.al



PRANVERA NË PRISHTINË

Njëra nga këngët më të bukura për Prishtinën titullohet “Pranvera në Prishtinë”. Pranvera është sinonimi i dashurisë dhe lulëzimit, por edhe i vendimeve që prekin përditshmërinë tonë.

Tradicionalisht, në pranverë vendosim për investimet tona, vendosim për shkollimin tonë dhe vendosim edhe për planet për pushimet e merituar të verës. Në këtë numër, do t’ju sjellim një seri shkrimesh që na tregojnë për rilindjen kombëtare, e cila u kurorëzua në pranverën e vitit 1878. Do të sjellim rrugëtimin historik të rilindjes dhe një udhëzues turistik për qendrën e rilindjes kombëtare, qytetin e Prizrenit.

Të dashur lexues, kryesisht ju nga diaspora, pranvera është, gjithashtu, koha kur të rinjtë dhe të rejtat që përfundojnë shkollimin e mesëm marrin vendimin për shkollimin dhe profesionin e së ardhmes. Në kohën kur një pjesë e madhe e njerëzve nga Kosova synojnë të zhvillojnë studimet jashtë vendit, ne do t’ju sjellim profile interesante të kampuseve nga Kosova, të cilat janë bërë universitete atraktive për studentët e huaj. Në reportazhin për degën e Fakultetit Juridik në drejtësi tranzicionale, do të kuptoni për shkollimin në gjuhën angleze, i cili po pilotohet në Universitetin e Prishtinës.

Si gjithmonë, në GP Magazinë, ne do të kujdesemi t’ju sjellim rrëfime të biznesmenëve, të cilët, në kushtet e Kosovës, po arrijnë të krijojnë marka që eksportohen në gjithë Evropën.

Edhe në këtë numër, do të vazhdojmë t’ju sjellim në vëmendje zona dhe bukuri të papara të vendit tonë, të cilat nuk i keni vizituar dhe për të cilat nuk keni informacione.

Këshillat nga mësuesit për nxënësit nga diaspora do të vazhdojnë të jenë pjesë e rëndësishme e këtij numri, ndërsa në rubrikën e përrallave do të vazhdojmë të sjellim personazhet mitike të historisë sonë, të treguara përmes përrallave për më të vegjlit tanë.



Adresa: Prishtinë, Mati 1. nr.31
Tel: + +383 44 326 143
E-mail:service@gp-aviation.net
marketing@gpmagazine.info



LEXONI NË KËTË NUMËR



08-09

GP Aviation, me rekord
lidhjesh nga Prishtina
drejt botës

10-11

Eksploro Parisin



FAQE 18, Të rinjtë e Kosovës jetojnë me prindërit

FAQE 36-37, Mali i Shkëlzenit – perlë e Alpeve Shqiptare

FAQE 42-45, Investimet në energji, mundësi e mirë për biznesmenët

FAQE 48-49, Feride Rushiti, aktivistja e drejtave të njeriut e nominuar për Çmimin Nobel për Paqe

FAQE 53-55, Programet atraktive për studentët nga Evropa në Universitetin e Prishtinës



14-17

Prizreni, qyteti që ruan historinë



20-21

Në moshë pensioni punojnë
për ta mbajtur të gjallë
artin e shkrirjes së filigranit



PRANVERA STUDENTORE E VITIT 1981

Një nga ngjarjet më të rëndësishme të shekullit 20 në Kosovë ishin demonstratat e vitit 1981. Më 4 mars 1981, studentët e Universitetit të Prishtinës nisën një protestë, e cila në nisje u paraqit si kërkesë për kushte më të mira studimi, e që më pas u shndërrua në një lëvizje politike për të drejta të barabarta për shqiptarët.

Demonstratat filluan në mars të vitit 1981, në Prishtinë, dhe shpejt u përhapën në qytete të tjera të Kosovës: Pejë, Gjakovë dhe Mitrovicë. Me gjithë natyrën paqësore të shumë prej demonstratave, regjimi jugosllav reagoi me dhunë dhe represion, duke përdorur policinë dhe ushtrinë për të shtypur protestat. Mijëra studentë dhe qytetarë u arrestuan dhe qindra të tjerë u plagosën ose humbën jetën. Pas këtyre ngjarjeve, Qeveria jugosllave ndërmori një sërë masash për të forcuar kontrollin mbi Kosovën.

Në nivel ndërkombëtar, demonstratat e vitit 1981 rritën ndjeshëm tensionet ndërmjet Kosovës dhe Qeverisë së Jugosllavisë, duke e bërë Kosovën një nga pikat kryesore të tensioneve në ish-Jugosllavi. Ky moment shënoi një fazë të rëndësishme në procesin

“ Demonstratat e vitit 1981 kishin një ndikim të rëndësishëm në historinë e Kosovës dhe në lëvizjet për të drejtat e shqiptarëve. Ato çuan në rritje të vetëdijes dhe mobilizimit të shqiptarëve të Kosovës për kërkesa të mëtejshme politike dhe të drejtat e tyre kombëtare. Po ashtu, këto demonstrata ndikuan në zhvillimin e ngjarjeve të mëvonshme, përfshirë shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, pas disa dekadash, në vitin 2008.

e integritit të Kosovës në trajektoren politike të vendeve të Ballkanit dhe një ngjarje historike që mbetet e rëndësishme për shqiptarët e Kosovës.

Në Kosovë kjo lëvizje njihet si Pranvera studentore dhe në mes muajve mars dhe prill organizohen ceremoni për të kujtuar lëvizjen. Njerëzit që dëshirojnë të kuptojnë më shumë për këtë lëvizje mund të vizitojnë kampusin e konvikteve në Prishtinë. Aty janë vendosur buste të viktimave të këtij organizimi, ndërsa zona ruan arkitekturën e asaj kohe.

NATURAL POOL & SPA

- 1 Pishinë e brendshme për të rritur Premium
- 1 Pishinë e brendshme për të rritur me qasje direkte në pishinën e jashtme (e përshtatshme për cdo stinë)
- 1 Pishinë për fëmijë

- 1 Indoor swimming pool for adults Premium
- 1 Indoor swimming pool for adults with direct access into the outdoor swimming pool (available at any season)
- 1 Swimming pool for children

- 4 Sauna të jashtme finlandeze
- 4 Sauna të brendshme finlandeze
- 1 Saun e brendshme me rreze infra të kuqe
- 1 Saun e brendshme bimore

- 4 Outdoor Finnish saunas
- 4 Indoor Finnish Saunas
- 1 Indoor Infrared Sauna
- 1 Indoor Herbal Sauna

- 5 Jacuzzi të jashtëm me ujë të ngrohtë
- 3 Jacuzzi të jashtëm me ujë të ftohtë
- 3 Jacuzzi të brendshëm

- 5 Outdoor Jacuzzis with warm water
- 3 Outdoor Jacuzzis with cold water
- 3 Indoor Jacuzzis

- 1 Hammam (Banjë Turke) | 1 Hammam (Turkish Bath)

- 2 Solarium për rrezitje | 2 Tanning Bed Solarium

RRETH NESH / ABOUT US

Natural Pool & SPA është një vend perfekt që ofron një përvojë unike për ata që kërkojnë qetësi dhe relaks! /

Natural Pool & SPA Is a perfect place that offers a unique experience for those looking peace and relaxation!

+383 48 473 473
WWW.NATURAL-KS.COM

Masazh | Massage

  
@NaturalPool&Spa



MESAZHI I GP AVIATION

Të dashur udhëtarë, mirë se vini në bordin e GP Aviation!

Me besimin tuaj, kompania jonë po rritet dhe bashkë me të edhe ekonomia e Kosovës.

Ky është viti i pestë prej kur kompania jonë operon me linjat e drejtpërdrejta nga Prishtina në drejtim të botës.



Mbi vizionin e themeleve të kompanisë, ne po vazhdojmë të rritemi, duke shtuar numrin e personelit, numrin e operimeve dhe numrin e flotës sonë ajrore. Vizioni ynë është i qartë: Prishtina do të jetë qendër e operimeve të sigurta dhe të përballueshme ajrore.

Flota jonë ajrore përbëhet nga avionë si: Boeing 737-400, Airbus 320, Airbus 319.

GP është duke vazhduar realizimin e planit ambicioz të shtimit të numrit të operimeve dhe, bashkë me ju, do të thyejmë rekorde të reja.



GP AVIATION, ME REKORD LIDHJESH NGA PRISHTINA DREJT BOTËS

Nga muaji mars, GP Aviation, kompania me numrin më të madh të fluturimeve nga Aeroporti i Prishtinës, ka zgjeruar rrjetin e saj të linjave ajrore, duke shtuar fluturime drejt katër qendrave të tjera të Evropës. Tani, pasagjerët mund të fluturojnë me aeroplanët e kësaj kompanie drejt aeroporteve të Kölnit, Dortmundit, Malmös, Göteborgut, Stockholmit, dhe Parisit.

Këto linja të reja janë pjesë e planit strategjik të GP Aviation për të rritur numrin e fluturimeve dhe për të përforcuar lidhjet e Kosovës me vendet e tjera të Evropës dhe më gjerë. Ky hap është një pjesë e rëndësishme e objektivit të kompanisë për të ofruar mundësi më të shumta udhëtimi për qytetarët dhe vizitorët e Kosovës, duke u mundësuar atyre të udhëtojnë më lehtë dhe me më shumë opsione drejt destinacioneve të ndryshme ndërkombëtare.

GP Aviation është operatori ajror më i madh në Aeroportin e Prishtinës dhe synon të ofrojë bileta ekonomike për pasagjerët që udhëtojnë nga dhe drejt Kosovës. Kompania e ka për qëllim të bëhet një nga liderшипet e aviacionit në rajon, duke siguruar një

shërbim cilësor dhe të përballueshëm për udhëtarët.

Flota ajrore e GP Aviation për sezonin e vitit 2025 përbëhet nga 8 aeroplanë të teknologjisë së lartë, të cilët operojnë çdo ditë nga Aeroporti i Prishtinës. Këta aeroplanë janë të pajisur me teknologji moderne për siguri dhe komoditet, duke ofruar një udhëtim të sigurt dhe të rehatshëm për pasagjerët.

Përmes këtij zgjerimi të fluturimeve dhe linjave të reja, GP Aviation ka për qëllim të lidhë më shumë Kosovën me botën dhe të ofrojë mundësi të mëdha udhëtimi për biznesmenë, turistë, dhe udhëtarë të tjerë që kërkojnë mundësi për të udhëtuar nga Kosova dhe për në Kosovë.

Një mundësi tjetër e shkëlqyer për udhëtarët është se biletat mund të blihen online, duke e bërë procesin e rezervimit më të lehtë dhe më të shpejtë. Për më tepër, çmimet janë promovionale për periudhën e verës, duke ofruar mundësi të shkëlqyera për udhëtime me çmime të ulura. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për ata që dëshirojnë të udhëtojnë me kosto të përballueshme, por pa e kompromentuar cilësinë e shërbimit.

FMO
Prishtinë
disa herë në javë



**FLUGHAFEN
MÜNSTER
OSNABRÜCK**

LINJAT KU OPERON GP AVIATION



BASEL • ZÜRICH • GENEVA • PARIS
LJUBLJANA • LUXEMBURG • GÖTEBORG • MALMO
STOCKHOLM • STUTTGART • MÜNCHEN • DÜSSELDORF
HANNOVER • MÜNSTER OSNABRÜCK • NÜRNBERG
BERLIN • MEMMINGEN • HAMBURG
KÖLN • DORTMUND • BREMEN

PRISHTINË

EKSPLORO PARISIN



Parisi është një nga qytetet më të vjetra të Evropës, me një histori dhe kulturë të lashtë. Zhvillimet e shumta në qytet dhe përreth qytetit kanë lënë pas një histori dhe arkitekturë të pasur, të cilat rekomandohet të eksplorojnë të paktën një herë gjatë jetës. Parisi njihet për një jetë të bujshme kulturore, për restorantet dhe verërat e famshme franceze, të cilat ju shoqërojnë gjatë gjithë vizitës tuaj.

Në një vizitë në Paris, ju rekomandohet të eksploroni këto hapësira:

KULLA EIFEL – Një nga simbolet më të njohura të Parisit dhe të Francës, Kulla Eifel është një pikë e domosdoshme për çdo vizitor. Mund të ngjitesh deri në majë për një pamje mahnitëse të qytetit.

LUVRI (MUSÉE DU LOUVRE) – Ky është muzeu më i madh dhe më i njohur në botë, i cili ruan disa nga veprat më të njohura të artit, përfshirë "Mona Lisën" e Leo nardo da Vinçit. Sigurohuni që të kaloni disa orë aty për të shijuar koleksionet e tij të pasura.

KATEDRALJA NOTRE-DAME – Një nga katedralet më të famshme gotike në botë. Edhe pse pati dëmtime nga zjarri i vitit 2019, ajo mbetet një vend i rëndësishëm për vizitorët.

SHESHI I CONCORDE DHE BULEVARDI CHAMPS-ÉLYSÉES – Sheshi i Concorde është një nga sheshet më të mëdha dhe më të njohura në Paris, i rrethuar nga disa atraksione. Bulevardi Champs-Élysées është i famshëm për dyqanet e tij luksoze dhe shëtitjet e bukura.

SHTËPIA E ARTIT MODERN (CENTRE POMPIDOU) – Ky muze i artit modern është një nga më të njohurit në botë dhe ofron një koleksion të pasur të veprave të artit të shekujve XX dhe XXI. Po ashtu, ndodhet në një ndërtesë shumë të veçantë, me stil arkitektonik unik.

MONTMARTRE DHE BAZILIKA E SHËN PJETRIT (SACRÉ-COEUR) – Një lagje e njohur artistike e Parisit, Montmartre, ofron pamje të jashtëzakonshme



të qytetit nga katedralja e Shën Pjetrit. Është një vend i shkëlqyer për të eksploruar kafenetë dhe galeritë e artit.

PARKA I TUILERIES DHE JARDINS DES PLANTES – Të dy këto parqe janë të bukura dhe ofrojnë mundësi për të kaluar kohë të qetë, duke shijuar natyrën dhe duke eksploruar histori dhe arkitekturë të ndryshme.

PALACI I VERSAJËS – Ndodhet pak jashtë Parisit dhe është një ndër monumentet më të mëdha të pasurisë dhe pushtetit mbretëror të Francës. Ky palat mbretëror është i njohur për kopshtet e tij të mrekullueshme dhe dhomat e pasura të brendshme.

MUZEU D'ORSAY – KY MUZE NDODHET NË NJË ISH-stacion treni dhe ruan një koleksion të shkëlqyer të artit impresionist, duke përfshirë veprat e artistëve të njohur, si Monet, Van Gogh dhe Degas.

SEINA DHE UDHËTIMET ME ANIJE – Një shëtitje me anije përgjatë lumit Seine është një mundësi fantastike për të parë disa nga atraksionet kryesore të qytetit, përfshirë Kullën Eifel dhe Katedralen Notre-Dame nga një këndvështrim të veçantë.

LE MARAIS – Një lagje e njohur për historinë, arkitekturën dhe jetën e natës. Mund të shijoni kafene dhe restorante të shijshme, dyqane të veçanta dhe galeri arti.

MUZEU RODIN – Ky muze

i është kushtuar veprës të skulptorit të famshëm francez, Auguste Rodin, dhe ka një koleksion të pasur të skulpturave të tij, përfshirë “Kryqi i Madh” dhe “Porta e Ferrit”.

DISNEYLAND PARIS – Disneyland Paris është një tjetër atraksion i shkëlqyer që duhet të vizitohet gjatë qëndrimit në Paris, sidomos për ata që janë adhurues të Disney-t dhe për familjet me fëmijë. Disneyland Paris është një nga destinacionet më të njohura turistike në Evropë dhe ndodhet afër qytetit, në Marne-la-Vallée, rreth 32 km nga qendra e Parisit.

Eksplorojeni Parisin dhe përjetoni bukurinë, historinë dhe kulturën e tij të pasur!







BÄCKEREI  **KONDITIONEIREI**

BERG AM LAIM
BAUMKIRCHNER STR.12
TEL:+491623962484





SHIJE E VËRTETË SHQIPTARE!

Mirësevini në furrat tona në München, aty ku tradita dhe shija bashkohen në çdo produkt! Nga buka e sapopjekur me brumë të punuar me dorë, deri te hyrëkët krokantë e emhëlsirat tradicionale, ne sjellim aromën dhe shijen e kuzhinës shqiptare në tryezën tuaj. Ejani të shijoni recetat e trashëguara brez pas brezi, të përgatitura me përbërës natyralë dhe dashuri!



**TRADITË,
SHIJE
DHE CILËSI**



FOSTENRIEDER-ALLE
WINTETTHURER STR.2
TEL: +4915510382613



vipa



SHIJE TË PAREZISTUESHME

Vipa Chips gjithmonë pranë jush!



PRIZRENI, QYTETI QË RUAN HISTORINË

Nga historia e deri te turizmi malor, oferta turistike që ofron Prizreni.



Prizreni pa dyshim është një prej vendbanimeve më të rëndësishme të Kosovës. Ky qytet tërheq vëmendjen e shumë vizitorëve, si të huaj apo nga viset e ndryshme shqiptare dhe diaspora.

Ivëndosur rrëzë maleve të Sharrit, të shpallura “Park Nacional”, në të dy brigjet e Lumëbardhit, Prizreni përgjatë historisë ishte i njohur si qendër e ëndësishme kulturore, politike dhe ekonomike.

Prizreni, me trashëgiminë kulturore dhe historike që ka, me plot të drejtë quhet edhe “Qytet muze”.

Është trashëgimia historike dhe kulturore, natyra e bukur, ajo që e bën këtë qytet mjaft tërheqës për t’u vizituar.



Pikërisht monumentet historike, si Kompleksi i Lidhjes së Prizrenit, Kalaja e qytetit, Hamami, objektet e kultit fetar, si kishat dhe xhamitë, rrugët me kalldrëm, kultura, mikpritja dhe ushqimet tradicionale, e bëjnë edhe më të veçantë dhe më tërheqës për ta vizituar këtë qytet.

Prizreni, me vendbanimet përreth, ruan dëshmi e monumente arkeologjike nga koha e neolitit, bronzit, hekurit, antikitetit e këtej.

Kjo dëshmohet nga artefaktet e shumta të zbuluara nga gërmimet arkeologjike, të bëra në një



varg lokalitetesh. Të dhënat arkeologjike dëshmojnë se Prizreni është njëri ndër qytetet më të vjetra të Evropës Juglindore dhe më gjerë.

Pasuria më e vlefshme e Prizrenit janë vlerat e tij të trashëguara nga shekujt e kaluar.

Këto vlera manifestohen me një arkitekturë të përsosur dhe strukturë të magjishme urbane në njërën anë dhe me traditat popullore të veçanta në anën tjetër. Prizreni është vendi ku takohen kulturat dhe qytetërimet e ndryshme, apo, siç njihet, edhe si një qytet multientik, ku bashkëjetesa në mes të shqiptarëve dhe pakicave është një nga vlerat e këtij qyteti.



Kompleksi i Lidhjes së Prizrenit, i vendosur buzë Lumëbardhit, në pjesën e “Marashit”, është një nga pikat kryesore për t’u vizituar në këtë qytet.

Në këtë kompleks muzeu, vizitorët kanë mundësi të shohin nga afër objektin e Lidhjes së Prizrenit. Po ashtu, edhe pjesën e muzeut në kuadër të këtij kompleksi, ku janë të ekspozuara artefakte të shumta, nga kohërat vjetra, që pasqyrojnë të kaluarën kulturore-historike të Prizrenit me rrethinë.



Brenda qendrës së mbrojtur historike të qytetit ndodhet edhe objekti i Hamamit të Gazi Mehmed Pashës.

Edhe në këtë objekt ka të ekspozuara artefakte të shumta, nga periudhat e ndryshme historike. Po ashtu, në këtë objekt organizohen shpesh edhe ekspozita të artistëve të ndryshëm.

OFERTA TURISTIKE E PRIZRENIT

Prizreni është njëri nga qytetet e pakta të Kosovës që ka struktura të organizuara për të mirëpritur vizitorët dhe për të ofruar guida turistike.

Bekim Bytyqi, një nga personat që merret me guidën turistike të Prizrenit, tregon se nga viti në vit numri i turistëve në këtë qytet po vjen duke u rritur.

Sipas tij, Prizreni tashmë, përveç qendrës së vjetër të qytetit, ofron edhe mundësi të tjera për turistët.

Ai shpjegon se vitet e fundit ofertës turistike i janë shtuar edhe atraksione të reja turistike.

“Kemi edhe sportet e ndryshme që janë mjaft tërheqëse për turistët. Kemi paraglajdin, sportin e

kajakut, hikingun, çiklizmin malor, skijimin, peshkimin, via ferrata, kampingun etj., që e bëjnë edhe më të kompletuar ofertën turistike të Prizrenit”, thotë ai.

Sipas Bytyqit, turistëve u intereson edhe pjesa e gastronomisë, e cila, sipas tij, është unike në këtë qytet.

“Është edhe pjesa e hoteleve, bujtinave dhe e gastronomisë ajo që u intereson gjithmonë turistëve të huaj. Ne edhe më tutje, krahasuar me atë çfarë ofron Prizreni, jemi mjaft atraktivë dhe mjaft konkurrues edhe sa u përket çmimeve, jemi ndoshta më të lirët në rajon dhe me gjerë. Po

ashtu, është edhe mikpritja, ndoshta më e rëndësishmja do të thosha për t’i pritur turistët që e vizitojnë qytetin tonë”, thotë ai.

Investimet në fushën e turizmit

Në qendrën e qytetit, përveç objekteve që kanë një stil të veçantë të ndërtimit, aty gjenden edhe xhami dhe kisha, që po ashtu janë pjesë e trashëgimisë së mbrojtur.

Ngjitja për në kala ende duhet të bëhet në këmbë, pasi, edhe pse ka kaluar më shumë se një dekadë që kur flitet për ndërtimin e një lifti, ai ende nuk ka nisur të ndërtohet.

Drejtori i Drejtorisë së Turizmit, Ramadan Tarashaj, thotë se këtë vit planifikojnë që t’i zhvillojnë procedurat e prokurimit për ndërtimin e liftit për në Kalanë e Prizrenit, mirëpo nuk ka një datë se kur mund të nisin dhe të përfundojnë këto punime.

Sipas tij, kësaj radhe, sipas studimeve të fizibilitetit, kanë arritur në përfundim që lifti të ndërtohet nga pjesa parapa Kalasë, apo siç njihet nga pjesa e “Marashit”.





“Presim që brenda këtij viti të nisim procedurat e prokurimit për ndërtimin e liftit për në Kalanë e qytetit. Kjo do të bëjë edhe më të lehtë qasjen për turistët që të ngjiten lart dhe të shijojnë pamjen e qytetit nga kalaja”, thotë Tarashaj.

Ai tha se si Drejtori e Turizmit janë të përqendruar që, përmes realizimit të projekteve infrastrukturore, ta bëjnë sa më funksionale sa i përket qasjes së turistëve në pjesën e vjetër të qytetit.

“Këtë vit veç e kemi përfunduar pjesën e qendrës në Shatërvan, ku janë kryer investimet më të mëdha që nga paslufta për rehabilitimin e gjithë rrjetit elektrik, i cili tashmë është futur nën tokë. Më nuk do të jetë ajo pamja e shëmtuar e kablllove”, tregon ai.

Ai theksoi se investimet që përmirësojnë fushën e turizmit janë bërë dhe janë duke u bërë edhe në zonat e fshatrave.

“E kemi rregulluar shtegun për tek Ujëvara në Korishë, e cila është një prej atraksioneve turistike. Po ashtu, kemi bërë investime edhe në fshatin Nashec. Pra, Prizreni, përveç pjesës së vjetër të qytetit, ofron edhe një larmi të turizmit, rural dhe malor”, tha ai.

Drejtorja për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik e Prizrenit për vitin 2025 ka paraparë rreth 600 mijë euro buxhet për të gjitha kategoritë, duke përfshirë edhe

ato të projekteve në fushën e investimeve kapitale.

Sipas të dhënave për turizmin, të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 5,246 vizitorë kanë qëndruar në Prizren në muajin janar të vitit 2025, derisa një vit më parë kishin qëndruar 4,088 persona.

Festivali DokuFest

DokuFest është Festival Ndërkombëtar i Filmit Dokumentar dhe të Shkurtër, festivali më i madh i filmit në Kosovë. Çdo vit festivali mbush kinematë rreth Qendrës Historike të Prizrenit, me një përzgjedhje prej më shumë se 200 filmash të zgjedhur nga e gjithë bota. Është themeluar në vitin 2002, me qëllim të rigjallërimit të kinemasë dhe jetës kulturore në Prizren. Ndër vite u rrit dhe u zgjerua në festivalin më të rëndësishëm të filmit dokumentar dhe të shkurtër në Evropën Juglindore.

Veçanërisht që nga viti 2019, DokuFest ka fituar statusin e vlerësuar si një festival kualifikues BAFTA për filma të shkurtër dhe në vitin 2022 ai është edhe festival nominues për Akademinë Prestigjioze Evropiane të Filmit, EFA.



Prizreni është i njohur për përgatitjet nga brumi, ndër të cilat shquhen: pogaça, topia, pitalka me vezë, pitja dhe flija. Gjellët tradicionale të Prizrenit përbëjnë esencën e kuzhinës

prizrenase. Po ashtu, çervish me qofte, specia me gjizë, tavë Prizreni, dollma, musak sarma, fasule, gullash, burjan me mish, elbasan tavë, janë gjellët më të shquara të Prizrenit. Gjithashtu, Prizreni shquhet edhe me lloje të ndryshme ëmbëlsirash, si: sheqerpare, tespishte, bakllava, sytliaç, tullumba dhe hallva, të cilat janë ndër më të preferuarat.



Komuna e Prizrenit, me sipërfaqe prej 640 km katrorë (5.94% e territorit të Kosovës), gjendet në jugperëndim të Kosovës, me 74 vendbanime dhe me rreth 150,000 banorë.

Kufizohet me komunën e Gjakovës, të Rahovecit, të Suharekës, të Shtërpçës, të Dragashit, të Mamushës, si dhe me shtetet fqinje: Shqipërinë dhe Maqedoninë Veriore. Rrafshi i Prizrenit gjendet në lartësi mbidetare rreth 400 metra dhe disa maje të Sharrit kalojnë lartësinë 2000 metra të lartësisë mbidetare.

TË RINJTË E KOSOVËS JETOJNË ME PRINDËRIT

Arritja e moshës 18-vjeçare për shumë të rinj në mbarë globin nënkupton pavarësimin nga familja. Ndarja fizike nga shtëpia dhe familja është pjesë e shumë kulturave perëndimore, të cilat synojnë pavarësimin ekonomik dhe social të fëmijëve të tyre.

Por kjo kulturë nuk është instaluar në Kosovë, ku shumica e të rinjve jetojnë me prindërit. Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 86% e të rinjve nga moshë 14 deri në 29 vjeç jetojnë me prindërit. Ndërkohë, vetëm 11.5% e të rinjve do të jetojnë vetëm nëse do t'u mundësonin kushtet financiare.

Në nivel ndërkombëtar, përqindja e të rinjve që jetojnë me prindërit është e lartë, gjithashtu. Shtetet e Bashkuara, për shembull, regjistrojnë se një në tre të rinj të moshës 18 deri në 34 vjeç jeton me prindërit. Po kështu, në disa shtete të Evropës, përfshirë Kroacinë, ky fenomen është i pranishëm, ku shtatë të rinj në dhjetë zgjedhin të jetojnë me familjen.

Shkalla e papunësisë së të rinjtë në Kosovë është afër 20% dhe pagat mesatare janë rreth 570 euro në muaj. Çmimet e qirave në Prishtinë janë të larta, duke nisur nga 200 euro dhe më shumë për një apartament, ndërsa çmimet e blerjes së banesave variojnë nga 1,000 euro për metër katror deri në mbi 2,200 euro për ato që ndodhen në qendër të qytetit. Këto kushte ekonomike bëjnë që jetesa me prindërit të jetë opsioni

më i mundshëm për shumicën e të rinjve, që nuk mund të përballojnë çmimet e tregut të pasurive të patundshme.

Sociologët e shpjegojnë këtë fenomen si një kombinim të faktorëve kulturorë dhe ekonomikë. Pavarësisht mentalitetit patriarkal, që e bën jetesën e pavarur të vështirë, kryesisht për vajzat, faktori kryesor është ekonomia. Pa mundësi të mjaftueshme financiare, shumica e të rinjve nuk kanë mundësi të jetojnë të pavarur, duke e bërë bashkëjetesën me familjen një alternativë më të leverdishme.

Në këtë kontekst, Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë disa masa për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe për të ofruar mundësi të përballueshme banimi. Ajo ka premtuar ndërtimin e 4,000 njësive banesore dhe projektet janë në fazën e tenderimit dhe planifikimit. Një ndër masat e reja është dhe miratimi i Ligjit për banim social, që synon të ofrojë mundësi më të mira për ata që kanë vështirësi financiare për të blerë banesa në tregun e lirë. Ky ligj parashikon që familjet e reja të mund të bëhen pronarë të banesave përmes pagesave mujore të përballueshme prej 120-150 eurosh.

Kjo situatë ka të ngjarë të ndihmojë në rritjen e mundësive për jetesë të pavarur për të rinjtë, duke pasur parasysh rritjen e kërkesës për banesa dhe nevojën për një qasje më të qëndrueshme financiare.



Vitamina • Minerale • Hekur • Proteina



Sempre

Rritemi së bashku me minerale dhe vitamina.

Biskotat Sempre janë të prodhuara nga përbërës të ushqyeshëm, duke i siguruar fëmijës tuaj vitamina dhe minerale thelbësore.

Duke kafshuar dhe përtypur biskotat Sempre, më të vegjlit tuaj stimulojnë mishin e dhëmbëve dhe lehtësojnë daljen e dhëmbëve të parë.



Një porcion (100g) SEMPRE biskota përmban:

Energji	Proteina	Sheqer	Yndyrna	Natrium
343 kcal	9.0 gram	24.13 gram	10 gram	0.3 gram
18%				

Vlera mesatare e rekomanduar për fëmi në bazë ditore për konsumim prej 1800 kcal





NË MOSHË PENSIONI PUNOJNË PËR TA MBAJTUR TË GJALLË ARTIN E SHKRIRJES SË FILIGRANIT

PRIZRENI, QYTETI I ARTIT TË SHKRIRË NË FILIGRAN

Përpunimi i filigranit dikur ishte krenaria e Prizrenit. Sot kanë mbetur më pak artizanë se gishtat e njërës dorë në ndërmarrjen që dikur vlonte nga puna.

Vetëm një pjesë e artizanëve mbetën, pasi tregtia, që dikur lulëzonte, është zvogëluar në prag të zhdukjes, për shkak të konkurrencës nga mallrat shumë më të lira, të prodhuara në masë nga jashtë.

Puna me filigranin është ruajtur gjeneratë pas gjenerate në qytetin e Prizrenit.

Dhe, sot, artizanati i filigranit është në rrezik të zhdukjes, edhe pse ka një pikë shprese, pasi janë trajnuar disa gjenerata të reja, duke u transferuar dhe ruajtur njohuritë dhe aftësitë e punimit me filigran.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, pavarësisht se është e shënuar në Listën e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, deri më tani nuk është bërë asnjë dokumentim profesional dhe inventarizimi i artizanatit filigran.

Në mars 2025, në ndërmarrjen "Filigrani" SHPK, e cila sot është e regjistruar si OJQ, takuam katër punëtorë, tre prej tyre mbi moshën

65-vjeçare, pra në moshë të pensionit.

Faik Bamja, 67-vjeçar, menaxher i ndërmarrjes "Filigrani" SHPK në Prizren, i ka kushtuar tërë jetën e tij punimit artizanal me filigran.

Ai kujton se si kishte rënë në kontakt, siç e thotë, 'me zanatin e punimit me filigran'.

"Unë si fëmijë e kam parë burrin e tezës sime që punonte me filigranin. Nga aty fillova të interesohesha dhe ja ku jam sot, pas më shumë se 40 vjetësh, ende edhe si pensionist jam aktiv, ende punoj me filigran", tregon Bamja.

"Fillimisht përfundova studimet në Zagreb në këtë fushë dhe pastaj gjeta punë menjëherë pas studimeve në Filigran në Prizren", tregon ai.

Ai tregon se vite më parë kishin mbi 20 dyqane. “Kemi qenë të shtrirë në bregdet, duke u nisur nga Kroacia, Sllovenia dhe Mali i Zi. Kishim edhe shkollën ku aftësoheshin nxënësit, të cilët e kryenin praktikën në Filigran, ku edhe shumica pastaj punësoheshin”, tregon Bamja.

Ai kujton se dikur produktet e tyre vlerësoheshin shumë, mirëpo me përkeqësimin e situatës, pas viteve të 80-ta dhe në kohën e sotme, me zhvillimin e teknologjisë, njerëzit sipas tij nuk interesohen shumë, sikurse dikur, për produktet e Filigranit.

“Këto janë të pakrahasueshme me këto produktet që sot na servohen nëpër dyqanet tona. Kjo është e gjitha punë dore. Çdo detaj këtu ka frymën e gjallë të punës dhe kemi ende qytetarë që e dinë vlerën e kësaj që ne punojmë këtu, megjithëse nuk është më siç ka qenë dikur”, thotë Bamja.

Ai shton se vitet e fundit, në bashkëpunim me Komunën e Prizrenit, kanë filluar të aftësojnë gjeneratat e reja, por që nuk është më interesimi siç ai e kujton kohën kur vetë ishte në moshë të re.

“Tani, vitet e fundit, kemi filluar t’i trajnojmë gjeneratat e reja që të punojnë me filigranin. Kjo është një shtysë që ta bartim këtë si një prej trashëgimive të brezi i ri. Janë disa të rinj që këtë profesion e kanë trashëguar nga prindërit apo familjarët e tyre, por që pak prej tyre e ushtrojnë këtë zeje”, tregon ai.

“Ne kemi kërkesë që Komuna dhe Ministria e Arsimit të na ndihmojë që të hapim një paralele në shkollë të mesme, pasi ne disa, edhe pse jemi në moshë të pensionit, kemi dëshirë që ta lëmë shkollën ku do të aftësoheshin gjeneratat e reja, në mënyrë që të mos vijë deri te zhdukja e kësaj

zeje”, thotë ai.

Ai thotë se në ndërmarrjen “Filigrani” sot janë vetëm 4 persona aktivë dhe tre prej tyre janë mbi 65-vjeçar, apo në moshë të pensionit. Mirëpo, nga dëshira që mos ta lënë të shuhet kjo zeje ata vazhdojnë të punojnë dhe pse në pension.

“Ne një ditë do të shkojmë, kemi mbetur këtu vetëm katër persona, dikur kemi qenë mbi 160. Nëse nuk na kushtojnë vëmendjen institucionet, kjo zeje, që dikur ishte simbol, apo krenaria e Prizrenit, rrezikon të zhduket”, thekson ai.

Fatime Baroti, edhe pse në moshë 78-vjeçare, vazhdon të punojë me filigranin. Ajo thotë se është e lumtur që, pasi ia ka kushtuar tërë jetën punës me filigranin, tani këtë profesion e ka trashëguar te mbesa e saj, e cila tani ka përfunduar trajnimin për punimin me filigran.

“Unë jam 78 vjeçe dhe ende po mundem me punu me filigranin dhe kështu do të vazhdoj sa të kem shëndetin, nuk do të ndalem, pasi



tërë jetën time ia kam kushtuar kësaj zeje. Sot jam shumë e lumtur që një nga pasardhësit e mi, mbesa ime, do ta trashëgojë këtë zanat, të cilit unë ia kam kushtuar tërë jetën time”, tregon Baroti.

BOX: Filigrani arriti në Kosovë në shekullin e 15-të dhe është prodhuar në rajon nga qindra artizanë që nga ajo kohë. Ndër më të mëdhenjtë dhe të njohurit e këtyre artizanëve është një grup prej 9 prodhuesve që punojnë së bashku në një punëtori të vogël në Prizren. Quajtur thjesht “Filigran”, kompania u formua fillimisht në vitin 1947, nga shteti jugosllav, së bashku me mjeshtrit vendas. Gjatë kësaj kohe, “Filigrani” kishte mbi 130 bizhuteritë në një ndërtesë. Kompania mbijetoi shumë vështirësi përpara se të detyrohej të mbyllej pas procesit të privatizimit, që erdhi pas luftës, në vitin 1999. Grupi i mbetur tani punon jashtë ndërtesës origjinale, duke prodhuar punë vërtet të hollë për klientët brenda dhe jashtë vendit.



20

YEARS TOGETHER



**ROCK
YOUR
SPACE**



S O L O S

www.solos.studio
f i solos.studio

**FURNITURE
LIGHTING
& MORE**



 **KERASAN**



**The beauty
remains eternal**

www.kerasan.net
f i kerasankosova

KOSOVA PËRBALLET ME RITJEN E ÇMIMEVE TË BANESAVE

Industria e ndërtimit në Kosovë ka kaluar në një periudhë të ndryshimeve të rëndësishme dhe kjo ka sjellë një ndikim të dukshëm në çmimet e banesave. Të dhënat më të fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë një rritje të konsiderueshme të kostos së ndërtimit, që ndikon drejtpërdrejt në rritjen e çmimeve të pasurive të paluajtshme.

Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) tregon se, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024 (tetor–dhjetor), kostoja e ndërtimit u rrit 0.6% krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2024. Ky ndryshim në rritje është një pasqyrë e vazhdimësisë së një trendi të shtuar të kostos për faktorët kryesorë të industrisë së ndërtimit, duke përfshirë transportin, materialet, pagat, energjinë dhe kostot e tjera.

Rritja më e dukshme ka ndodhur në disa aspekte të rëndësishme të këtij sektori. Kështu, transporti ka shënuar një rritje 2.4%, ndërsa pagat janë rritur 0.9%. Një tjetër rritje ka ardhur nga materialet, të cilat janë rritur 0.5%, dhe energjia, e cila ka regjistruar një rritje të vogël, 0.1%. Megjithatë, një rënie e vogël është regjistruar te makineritë, me një ulje prej 0.2%.

Në krahasim me vitin 2023, rritja e kostos së ndërtimit është shumë më e theksuar. Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024, rritja është 4.4%, që tregon një rritje të shpejtë dhe të qëndrueshme të kostos së ndërtimit në vitet e fundit. Ndryshimet më të mëdha janë shënuar në sektorët e energjisë, që kanë regjistruar një rritje të jashtëzakonshme prej 20.6%, pagave që janë rritur 12.8%, dhe transportit që ka përjetuar një rritje 10.9%. Po ashtu, materialet kanë pësuar një rritje prej 2.7% dhe makineritë janë rritur 0.8%.

Në këtë kontekst, ka një ndikim të drejtpërdrejtë edhe në çmimet e banesave. Para vitit 2024, çmimet e banesave në Prishtinë luhateshin mes 700-800 euro për metër

katror. Por, me rritjen e kostos së ndërtimit dhe faktorëve të tjerë të ekonomisë, këto çmime janë rritur në 1300-1400 euro për metër katror. Kjo ngritje e çmimeve është bërë e dukshme për blerësit dhe investorët, të cilët tani duhet të përballen me një treg më të shtrenjtë të pasurive të paluajtshme.

Këto të dhëna tregojnë se industria e ndërtimit po përballlet me një presion të vazhdueshëm të kostove dhe kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në çmimet e pasurive të paluajtshme. Rritja e kostos së ndërtimit ka çuar në rritjen e çmimeve të banesave, duke i bërë ato më të shtrenjta për blerësit dhe investorët. Në veçanti, çmimet e ndërtimit të banesave janë ngritur për shkak të rritjes së kostos së materialeve dhe transportit, si dhe për shkak të rritjes së pagave dhe energjisë që përdoret për procesin e ndërtimit.

Në përfundim, rritja e kostos së ndërtimit në Kosovë është një fenomen që ndikon drejtpërdrejt në çmimet e banesave dhe kjo ka pasoja të shumta për qytetarët dhe investorët. Megjithatë, zhvillimet e ardhshme në këtë industri do të vijnë nga ndryshimet në politikat qeveritare, investimet në infrastrukturë dhe përpjekjet për të ulur kostot e ndërtimit, që mund të ndikojnë në stabilizimin e çmimeve të pasurive të paluajtshme në të ardhmen.



TRANSPORT

PËR MALLËRA DHE AUTOMOBILË

KOSOVË
ZVICËR
KOSOVË

SHËRBIMET:

- ✓ Përvojë shumëvjeçare
- ✓ Profesionalizëm
- ✓ Siguri maksimale
- ✓ Kapacitete të mëdha
- ✓ Infrastrukturë moderne
- ✓ Çmime konkurruese



KONTAKT:

Zvicër: +41 76 700 2121, +41 79 640 1306
Kosovë: +383 44 336 987, +383 49 227 200

MBI 8 MIJË VIZITORË NË MUZEUN E HISTORISË SË REZISTENCËS - REPORTING HOUSE

Vizitorë nga mbarë bota po e vizitojnë muzeun Reporting House, në zemër të Prishtinës, për të mësuar për historinë mbi një dekadë të rezistencës së popullit të Kosovës për liri. Aktivitete të shumta i presin vizitorët edhe gjatë muajve mars dhe prill.

NGA: LEONORA ALIU

Muzeu i rezistencës, Reporting House, është shndërruar tashmë në atraksion turistik për vizitorë të shumtë që e frekuentojnë Prishtinën. Që nga hapja, më 10 qershor 2024, muzeu numëron mbi 8 mijë vizitorë nga vende të ndryshme të botës.


Reporting House, që gjendet në katin e parë të objektit të famshëm të shtëpisë së mallrave “Gërmia”, në sheshin Skënderbeu (mu prapa statujës së Skënderbeut), është transformuar falë projektit të Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) në Kosovë dhe Prishtina Biennale, në një hapësirë ku gazetaria, arti dhe historia ndërthuren për të ringjallur reflektimin mbi të kaluarën.

Ky destinacion i ri, kulturor dhe historik, po vazhdon të tërheqë shumë njerëz, përfshirë turistë, figura publike, politikanë, diplomatë, artistë lokalë e botërorë, diasporë, dhe mijëra nxënës të shkollave publike e private, nga të gjitha nivelet e arsimit.

NJË UDHËTIM HISTORIK PËRMES GAZETARISË DHE ARTIT BASHKËKOHOR

Hapja e ekspozitës më 10 qershor të vitit 2024 shënoi 25-vjetorin e përfundimit të luftës në Kosovë, duke prezantuar materiale gazetareske, video-xhirime, fotografi dhe artefakte historike, të vendosura krahas veprave bashkëkohore artistike. Ndër vizitorët e parë ishin figura të rëndësishme politike dhe kulturore, përfshirë presidenten e Kosovës, zonjën Vjosa Osmani - Sadriu, dhe kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, por edhe ambasadorë dhe artistë ndërkombëtarë.

Përparim Rama, kryetari i Prishtinës, foli në hapjen e



Fletorja e fëmijëve të familjes Jashari, e gjetur në Prekaz, në shtëpinë e Hamëz Jasharit, pas sulmit në Prekaz ndaj familjes Jashari, në mars të vitit 1998, nga Donika Shahini - Lami/Foto: Reporting House.

ekspozitës për rëndësinë e materialeve të paraqitura.

“Është e rëndësishme që në këtë ekspozitë ta shohim trashëgiminë tonë moderne, nga greva e famshme e minatorëve të “Trepçës”, kur ata kërkuar të drejta të barabarta me etnitë e tjera në ish-Jugosllavi, te rezistenca paqësore e udhëhequr nga Rugova dhe më pas kryengritja e armatosur e UÇK-së dhe ndërhyrja e NATO-s. Të gjitha këto e bënë të mundur që ne të jemi përgjegjës për të ardhmen tonë, ta planifikojmë dhe ta trasojmë rrugën tonë – ne jemi ata që e bëjmë këtë, jo dikush tjetër në emrin tonë”, tha Rama në hapje, më 10 qershor të vitit 2024.

Jeta Xharra, drejtoreshë ekzekutive e BIRN-it, njëherësh producente e Muzeut Reporting House, e nisi karrierën e saj gazetareske gjatë luftës në Kosovë, si përkthyes dhe producente lokale për BBC asokohe, dhe, përmes bashkëpunimit të saj, arriti që të sjellë në muze arkivat e mediave të ndryshme ndërkombëtare, nga mbulimi i rezistencës civile dhe asaj të armatosur gjatë luftës në Kosovë.

“Njëzet e pesë vjet pas luftës, është koha që vitet '90 t'i vendosim në një muze dhe të mos vazhdojmë të jetojmë ende në to. Është, gjithashtu, koha për të krijuar një narrativë të përbashkët, të balancuar dhe gjithëpërfshirëse, mbi atë që ka ndodhur – dhe cila është mënyra më e mirë për ta bërë këtë, sesa përmes raportimeve të medias ndërkombëtare të asaj kohe? Po ashtu, është thelbësore të ruajmë kujtesën mbi përpjekjet dhe rezistencën civile, e cila është e rrënjësor thellë në kulturën tonë. Kosovës i ka munguar një muze modern që, pa patos, përkujton kontributin e popullsisë civile për lirinë që gëzojmë sot”, tha Xharra.



Një ndër synimet e Jeta Xharrës ishte që gjeneratat e reja të mësojnë drejtpërsëdrejti nga materialet faktike për të kaluarën e Kosovës, historinë moderne të saj, që shënohet me rezistencën për liri, por edhe të ofrojë një hapësirë publike për të reflektuar mbi të kaluarën, si nevojë për ndërtimin e paqes në të ardhmen.

Ndërkaq, kuratori Gazmend Ejupi, artist dhe profesor i artit, sjell ekspertizën e tij nga Londra, ku studioi dhe punoi për dy dekada si artist dhe kurator, sjell punime ndërkombëtare të artit bashkëkohor, të cilat kanë për temë përvojat e civilëve në luftërat e tjera në botë. Ejupi ka kuruar hapësirën e muzeut duke u dhënë fokus rezistencës civile dhe dëshmime mbi diversitetin kulturor të Kosovës në periudhat 1989-1999, por edhe duke e lidhur përvojën e Kosovës me atë ndërkombëtare, duke prezantuar kështu të dhëna për Kosovën që shumëkush nga gjeneratat e lindura pas luftës nuk i ka mësuar në shkollë.

“Ne kemi gërrshetur materialet e gazetarëve, fotografitë dhe videot, me artin bashkëkohor, i cili trajton temat e përvojave të refugjatëve dhe konflikteve globale. Kjo ofron një qasje reflektuese mbi rezistencën tonë lokale, duke sjellë njëkohësisht artistë të njohur ndërkombëtarë në një hapësirë kulturore të transformuar”, tha Ejupi.

Duke kombinuar faktet gazetareske me vepra të artit bashkëkohor nga bota, Ejupi ofroi një mundësi të jashtëzakonshme të përjetimit të së kaluarës kolektive për çdo gjeneratë.

Një formë e tillë e kurimit të një muzeu historik, nga ekspertë ndërkombëtarë të fushës po konsiderohet si unike dhe e rrallë. Fatos Üstek, kuratorja me renome

ndërkombëtare, nga Londra, e cila ka punuar ndërkombëtarisht nga Mbretëria e Bashkuar deri në Kore, komentoi mbi modelin artistik që përfaqëson Reporting House, duke e krahasuar me modelet e bienaleve, të cilat shërbejnë për të reflektuar mbi ndërgjegjësimin shoqëror ndaj konflikteve apo realiteteve të shoqërive.



Foto: Fatos Üstek në një diskutim në Reporting House

“Formati i bienales, që në njëfarë mënyre nisi Avangardën në artin bashkëkohor, ka qenë një platformë për praktika me ndërgjegjësim shoqëror, ku janë përdorur edhe materiale faktike nga gazetarët. Për shembull, Bienalja e Gëangju nisi si reagim ndaj kryengritjes së Gëangjusë, e cila përfundoi me vrasjen e mijëra njerëzve. Që nga viti 1995, çdo edicion i Bienales së Gëangjusë ka pasqyruar një realitet të asaj që po ndodh në botë, jo vetëm në rajon”, shpjegoi Üstek.



Foto: Adrian Paci dhe Gazmend Ejupi gjatë diskutimit në Reporting House në Prishtinë

TAKIME QË ZGJOJNË KUJTESËN KOLEKTIVE

Me kalimin e muajve, Reporting House u shndërrua në hapësirën publike që synohej, platformën që ofron kujtimin kolektiv mbi historinë e Kosovës. Si hapësirë e tillë, Reporting House jo vetëm që ka marrë vëmendje të jashtëzakonshme për vizita, por ka organizuar një seri ngjarjesh që kanë thelluar dialogun mbi drejtësinë tranzicionale dhe pasojat e luftës. Ndër to, bashkëbisedimi me ambasadorin William Walker, që

ndau kujtimet e tij për vitet 1998-1999, duke sjellë një refleksim të thelluar mbi rëndësinë e raportimit mediatik në kohë krizash dhe ngjarjet në Reçak, si dhe punën në librin e tij të fundit, të botuar me kujtimet nga Reçaku dhe Kosova.

“Do të doja të shihja këtu edhe një veturë të portokalltë të OSBE-së”, tha Walker derisa e vizitoi muzeun Reporting House.

“Shumë është folur për komandantët e UÇK-së, luftëtarët guerilë dhe politikanët, por jo aq shumë për civilët, prandaj kjo është shumë e rëndësishme çka keni bërë ju në këtë hapësirë”, vlerësoi ai.



Foto: Rea Kurtaj/Reporting House

Një organizim tjetër i muajit shkurt të këtij viti ishte edhe diskutimi me dr. Feride Rushiti, drejtore e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRT), njëherësh e nominuar për çmimin “Nobel për Paqe” për vitin 2025, për punën që ajo bashkë me organizatën e saj kanë bërë për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Ajo dhe stafi i saj vizituan Reporting House, duke e vlerësuar punën e gazetarëve dhe kuratorit për dokumentimin e historisë së kaluar të Kosovës.

“Po du me shfrytëzu rastin me ju përgëzu për punën që keni bërë, sepse me të vërtetë roli i gazetarëve gjatë luftës ka qenë shumë i rëndësishëm. Dhe kjo që keni bërë me muzeun po e dokumenton memorien tonë kolektive, për çka ka pasur shumë nevojë, sepse të kaluarën tonë faktike nuk mundet me e mohu askush. Prandaj ju përgëzoj!”, tha Rushiti.



Foto: Rea Kurtaj/Reporting House

NJË QENDËR PËR REFLEKTIM DHE EDUKIM

Duke u shndërruar në një pikë referimi për edukimin dhe refleksimin historik, Reporting House ka mirëpritur vizita nga shkolla publike dhe private, duke u dhënë brezave të rinj mundësinë të mësojnë mbi të kaluarën përmes rrëfimeve autentike. Gjithsej 24 shkolla publike dhe private, nga të gjitha nivelet e edukimit: fillor, i mesëm, universitete etj., e kanë vizituar Reporting House dhe kanë marrë pjesë në diskutimet për drejtësinë tranzicionale.



Foto: Reporting House

SHËNIMI I 17-VJETORIT TË PAVARËSISË

Me rastin e 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Reporting House, në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, ka lansuar projektin “Gratë e UÇK-së rrëfejnë”. Ky projekt dokumenton rolin e grave nga rajoni i Prishtinës në luftën për liri të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Komuna e Prishtinës, respektivisht këshilltarja e kryetarit të Prishtinës, Jonada Jashari, në cilësinë e hulumtueses dhe regjisores, ka realizuar video-intervistat me gratë veterane, duke sjellë dëshmi të bazuara në kujtimet e tyre. Këto intervista janë te ekspozuara në Reporting House dhe të qasshme për të gjithë ata të cilët janë të interesuar t'i dëgjojnë dhe të kuptojnë më tepër për rolin e grave në luftën për liri të UÇK-së, përmes rrëfimeve autentike të Zymrie Vitia, Ramize Abdullahu - Salihu, Ibadete Canolli, Hyrie Veliu, dhe Emine Brahimi.

Projekti synon të hapë një diskutim më të gjerë mbi përvojat e grave në luftë dhe kontributin e tyre të rëndësishëm në historinë moderne të Kosovës. Projekti “Gratë e UÇK-së rrëfejnë” ka dokumentuar për herë të parë historitë e grave që kanë qenë pjesë e luftës, duke ndriçuar rolin e tyre shpesh të harruar.



Foto: Rea Kurtaj/Reporting House



NJË DESTINACION PËR ÇDO UDHËTAR

Për ata që zbresin në Prishtinë dhe kërkojnë të kuptojnë më shumë mbi historinë dhe identitetin e Kosovës, Reporting House është një ndalesë e domosdoshme. Kjo hapësirë nuk është vetëm një muze, por një testament i fuqisë së gazetarisë dhe artit në ruajtjen e së vërtetës dhe kujtesës kolektive.



Nëse udhëtimi juaj ju sjell në kryeqytetin e Kosovës, mos e humbni mundësinë për të vizituar këtë qendër unike që sfidon kohën dhe hap

horizonte të reja përmes rrëfimeve që nuk duhet të harrohen. Në muajin mars, në prag të epopesë së lavdishme të UÇK-së dhe muajit që shënohet me rezistencë historike, Reporting House do të organizojë një seri të diskutimeve publike.

Fletorja e fëmijëve të familjes Jashari, e gjendur në rrënojat e shtëpisë së Hamëz Jasharit, menjëherë pas sulmit të 7 marsit 1998, gjendet e ekspozuar si artefakt në Reporting House. Më 7 mars organizohet diskutim i hapur për shkollat shtëpia, ndërkaq më 8 mars zhvillohet biseda për protestat e grave “Bukë për Drenicën” dhe “Protesta me Fleta të Bardha”, që të dyja këto të organizuara dhe të udhëhequra nga gratë aktiviste të Kosovës në mars të vitit 1998.

Muzeu është i hapur prej së martës deri të shtunën prej 10:00-18:00 dhe hyrja është falas, duke përfshirë edhe udhërrëfyesit që i shoqërojnë vizitorët në shqip, anglisht dhe gjermanisht.

Nëse doni të rezervoni udhërrëfimin në këtë muze nga gazetarët që kanë raportuar gjatë luftës, kjo mund të bëhet për grupe vizitorësh nëse e bëni rezervimin në numrin e telefonit: 048 831 998.

Foto: Dhurata Bajrami/Reporting House



FILARMONIA E KOSOVËS, ME PROGRAM TË PASUR GJATË MAJIT DHE QERSHORIT

Filarmonia e Kosovës ka përgatitur një sezon të jashtëzakonshëm koncertesh për periudhën mars - qershor 2025, i cili do të sjellë një përzierje të mrekullueshme të muzikës klasike, koncerteve solistike dhe mbrëmjeve tematike. Aktivitetet do të zhvillohen në disa lokacione të njohura, duke përfshirë Pallatin e Rinisë në Prishtinë, si dhe qytete të tjera, si Gjakova dhe Sofja.

Një nga ngjarjet më të rëndësishme është koncerti i 28 marsit, dedikuar 150-vjetorit të lindjes së kompozitorit Maurice Ravel, i cili do të udhëhiqet nga dirigjenti Marco Crispo, me solistët Liza Kerob dhe Altin Tafilaj. Po ashtu, Filarmonia do të zhvillojë një mbrëmje të veçantë për Philip Glass, më 5 prill dhe një koncert për



340-vjetorin e lindjes së Bach, më 18 prill.

Koncerti i "Messiah" të Händel do të ndodhë më 9 dhe 10 maj, dedikuar dirigjentit Bahri Çela, ndërsa koncertet do të vazhdojnë edhe jashtë vendit, me një performancë të orkestrës në Sofje, më 17 maj.

Qershori do të sjellë, gjithashtu, mbrëmje të jashtëzakonshme,

duke përfshirë performancën me Ermonela Jaho më 8 qershor dhe koncertin madhështor të orkestrës dhe Baletit të Kosovës më 20 dhe 21 qershor.

Ky sezon është një mundësi unike për t'u njohur me kompozitorët e njohur dhe për të shijuar performancat e disa prej solistëve dhe dirigjentëve më të shquar të momentit.

KALENDARI I NGJARJEVE TË FILARMONISË SË KOSOVËS PËR PERIU DHËN 28 MARS – 21 QERSHOR 2025:

MARS 2025

28.03.2025 – Java e Frankofonisë, Atelieja e Pallatit të Rinisë, Prishtinë
150-vjetori i lindjes së Maurice Ravel
Orkestra e Filarmonisë së Kosovës
Dirigjent: Marco Crispo
Solistë: Liza Kerob – violinë, Altin Tafilaj – violë

PRILL 2025

05.04.2025 – Philip Glass Night – Mbrëmje Amerikane, Atelieja e Pallatit të Rinisë, Prishtinë
Orkestra e Filarmonisë së Kosovës
Dirigjent: Gregory Charette
Solist: Maximilian Hart

15.04.2025 – Frymë, Autostrada Hangar, Prizren
Orkestra Frymore e Filarmonisë së Kosovës

Dirigjent: Dario Salvi
Solist: Konstantin Manaev

18.04.2025 – Bach: 340-vjetori i lindjes, Atelieja e Pallatit të Rinisë, Prishtinë
Kori dhe Orkestra e Filarmonisë së Kosovës
Dirigjent: Jörn Boysen

25.04.2025 – Atelieja e Pallatit të Rinisë, Prishtinë
Orkestra e Filarmonisë së Kosovës
Dirigjent: Aurélien Azan Zielinski
Solist: Félicien Brut

MAJ 2025

09 & 10.05.2025 – Händel: Messiah, Atelieja e Pallatit të Rinisë, Prishtinë
Koncert dedikuar dirigjentit Bahri Çela
Orkestra e Filarmonisë së Kosovës
Dirigjent: Marcio da Silva

15.05.2025 – Pallati i Kulturës "Asim Vokshi", Gjakovë
Orkestra e Filarmonisë së Kosovës
Dirigjent: Nayden Todorov
Solistë: Besa Llugiqi – soprano, Vitaly Vatulya – saksofon

17.05.2025 – Salla "Bulgaria", Sofje
Orkestra e Filarmonisë së Kosovës

Dirigjent: Nayden Todorov
Solistë: Besa Llugiqi – soprano, Vitaly Vatulya – saksofon
30.05.2025 – Atelieja e Pallatit të Rinisë, Prishtinë
Orkestra e Filarmonisë së Kosovës
Dirigjent: Peter Valentovic
Solistë: Sofya Gulyak – piano

QERSHOR 2025

08.06.2025 – Salla e Madhe e Pallatit të Rinisë, Prishtinë
Orkestra dhe Kori i Filarmonisë së Kosovës
Dirigjent: Jacopo Sipari di Pescaseroli
Solistë: Ermonela Jaho

14.06.2025 – Kisha Katolike Shën Ndou, Prishtinë
Kori i Filarmonisë së Kosovës
Dirigjente: Michelle Jensen

20 & 21.06.2025 – Salla e Madhe e Pallatit të Rinisë, Prishtinë
Orkestra dhe Kori i Filarmonisë së Kosovës
Kori i Operës, Kori i Përzier i Selanikut, Trupa e Baletit të Kosovës
Dirigjent: Toshio Yanagisawa
Koreograf: Toni Candeloro

PRISHTINA

RENT A CAR

Shijo Pushimet Tuaja

Me veturat e modeleve të fundit!



Skeno > Shkarko > Rezervo > Zbritje përfito



+38344240383



rentacar-prishtina.com



GJERAVICA, PERLA KOSOVARE QË DUHET EKSPLORUAR

Në një udhëtim që zgjat më pak se 3 orë nga Prishtina, ju do të mund të vizitoni njërin nga zonat më të bukura turistike të Ballkanit. Mali i Gjeravicës, një zonë alpine e paeksploruar shumë deri më tani, është shndërruar në vitet e fundit në një zonë atraktive për sportet ekstreme dimërore.

Falë punës së Sebastian Fleiss, një shtetasi kroat, i cili promovon guidat në këtë zonë, Gjeravica është shndërruar në një zonë atraktive për turistët e huaj nga mbarë bota.

E veçanta e Gjeravicës është zona e egër, e cila mundëson aventura të papërfjetuara deri më tani. Rruga deri te zona është malore dhe zakonisht tek shtigjet e skijimit shkohet vetëm me motor të borës, për shkak se në zonë nuk ka teleferik.

Kjo e bën zonë atraktive dhe shumë të veçantë për turistët malorë. Media botërore, përfshirë "Financial Times", kanë përshkruar se Gjeravica, një nga zonat më të bukura malore të Kosovës, është një destinacion i jashtëzakonshëm për ata që kërkojnë të shijojnë

sportet dimërore dhe natyrën e paprekur gjatë sezonit të dimrit.

E vendosur në jugperëndim të





Kosovës, kjo zonë ofron mundësi të shumta për vizitorët që kërkojnë aventura dhe relaksim në një ambient të qetë malor.

Për ata që preferojnë aventurat malore, Gjeravica ofron mundësi të shkëlqyera për shëtitje nëpër pyje të mbuluara me dëborë. Ekskursionet tilla janë tërheqëse për vizitorët që

duan të përjetojnë bukurinë natyrore të Kosovës gjatë dimrit, duke ecur nëpër rrugë të paprekura dhe duke shijuar peizazhe të mahnitshme që ofron kjo zonë malore. Po ashtu, gjatë këtyre shëtitjeve, vizitorët mund të shijojnë pamjet spektakolare të ujëvarave të Gjeravicës, të cilat, të mbuluara me akull gjatë dimrit, krijojnë një pamje të jashtëzakonshme natyrore që nuk mund të humbet.

Në një periudhë kur shumë njerëz duan të largohen nga zhurma e qytetit, Gjeravica ofron një mundësi të shkëlqyer për relaksim. Atmosfera e qetë malore, majat e mbuluara me dëborë dhe ajri i pastër, janë ideale për ata që kërkojnë një pushim të vërtetë. Gjatë dimrit, zona ofron pamje spektakolare që të lejojnë të krijosh kujtime të paharrueshme.

Për më tepër, shumë struktura akomoduese dhe restorante në Gjeravicë ofrojnë mundësi të mira për t'u ngrohur pas një dite të mbushur me aktivitete. Gatimet tradicionale të zonës janë një tjetër arsye që vizitorët

të rikthehen në këtë destinacion dimëror. Ushqimet e ngrohta, të përgatitura me produkte vendase, përfshirë pite, tavë dhe ushqime të tjera tradicionale, janë një përvojë e paharrueshme që e kompletton vizitën tuaj.

“Gjeravica është gjithashtu e lehtë për t'u arritur gjatë dimrit, me rrugë të mirëmbajtura që mundësojnë një qasje të thjeshtë për turistët, edhe pse mund të ketë disa vështirësi për shkak të kushteve të dimrit.

Në përfundim, Gjeravica ofron një kombinim të shkëlqyer të natyrës, sporteve dimërore dhe mundësive për relaksim, që e bëjnë atë një destinacion të pashembullt gjatë sezonit të dimrit. Për ata që kërkojnë një largim nga rutina e përditshme dhe dëshirojnë të shijojnë bukurinë e natyrës malore, ujin e ftohtë të ujëvarave dhe gatimet tradicionale, Gjeravica është padyshim një opsion i shkëlqyer.



ART
MOTION

315+
KANALE TV

40+ LIGA
SPORT HD

INTERNET DERI
500 Mbps

TË GJITHA
KANALET
DIGITALB

tring

BIG BROTHER
VIP KOSOVA

BIG BROTHER
VIP

Tjetër nivel

Çdo ligë,
çdo emocion.



www.artmotion.net 0800 20 500



POSSIBILITIES & PARTNERS

REKLAMO BIZNESIN NË AEROPLAN

NA KONTAKTONI:

www.pfp-ks.com

info@pfp-marketing.com

+383 43 899 331

AZET

FAST LIFE FOREVER TOUR 2026



**GET
YOUR
TICKET**

STUTTGART --- 09.01.2026

MÜNCHEN ----- 10.01.2026

FRANKFURT ---- 11.01.2026

ZÜRICH ----- 13.01.2026

BERLIN ----- 15.01.2026

HAMBURG ----- 16.01.2026

KÖLN ----- 17.01.2026



MALI I SHKËLZENIT- PERLË E ALPEVE SHQIPTARE

Mali i Shkëlzenit, me një lartësi mbresëlënëse prej 2,407 metrash, shtrihet në Alpet Shqiptare, duke ofruar një nga peizazhet më të mrekullueshme dhe të paprekura të Shqipërisë. I vendosur në veri të vendit, afër Tropojës dhe kufirit me Kosovën, ky mal është një destinacion ideal për adhuruesit e natyrës dhe aventurës.

ÇFARË MUND TË VIZITONI?

Përveç majës së Shkëlzenit, e cila ofron një pamje spektakolare mbi Luginën e Valbonës dhe vargmalet përreth, vizitorët mund të eksplorojnë edhe zona të tjera të veçanta, si:

- **Lugina e Valbonës** – Një nga

atraksionet më të bukura natyrore të Shqipërisë, e njohur për lumin e kristaltë, pyjet e harlisura dhe peizazhin e saj malor të mahnitshëm.

- **Ujëvara e Valbonës** – Një perlë natyrore, e vendosur mes

maleve, që ofron një vend të përsosur për fotografi dhe relaksim.

- **Liqenet e Sylbicës** – Një grup liqenesh akullnajore të vendosura mes Alpeve, perfekte për eksploruesit që kërkojnë një eksperiencë të veçantë në natyrë.
- **Parku Kombëtar i Valbonës** – Një zonë e mbrojtur e pasur me faunë dhe florë të rrallë, ku vizitorët mund të hasin shqiponja, dhelpra dhe madje edhe arinj të vegjël.
- **Fshatrat Çerem dhe Dobërdol** – Fshatra tradicionale alpine,





në të cilat mund të përjetoni mikpritjen e ngrohtë të vendasve dhe të shijoni jetën rurale të zonës.

RRUGËTIMI NGA SHKËLZENI NË GJERAVICË

Për adhuruesit e ecjeve të gjata malore, rrugëtimi nga Mali i Shkëlzenit në Gjeravicë – maja më e lartë e Kosovës me 2,656 metra lartësi – është një aventurë e jashtëzakonshme.

Ky itinerar konsiderohet një nga më të bukurit në Alpet Shqiptare, pasi kalon përmes luginave të thella, pyjeve të virgjëra dhe livadheve alpine. Rruga përshkon zonën e Dobërdolit, një nga vendet më të njohura për kamping dhe ndalesa për alpinistët. Dobërdoli është një fshat veror i banuar nga barinjtë, ku mund të gjeni ushqime të freskëta tradicionale dhe të pushoni para vazhimit të rrugës.

Nga Dobërdoli, ngjitja drejt Gjeravicës kërkon rreth



6-8 orë ecje, në varësi të kushteve të motit dhe nivelit të përgatitjes fizike. Ky segment i shtegut ofron pamje spektakolare mbi liqenet akullnajore të zonës dhe një panoramë të gjerë mbi Kosovën dhe Shqipërinë.

Ky rrugëtim është i përshtatshëm për alpinistë me përvojë dhe eksplorues të natyrës që kërkojnë një sfidë të re. Pasi të arrini në majën e Gjeravicës, do të shpërbleheni me një pamje të jashtëzakonshme mbi vargmalet e Ballkanit dhe një ndjenjë të fuqishme arritjeje.

Ushqimet tradicionale që duhet t'i provoni
Vizita në këtë zonë nuk do të ishte e plotë pa shijuar ushqimet tradicionale të veriut të Shqipërisë.

Disa nga specialitetet më të njohura përfshijnë:

- **Fli** – Një nga gatimet më tradicionale, e përgatitur me shtresa brumi dhe e pjekur ngadalë me zjarr të ngrohtë.
- **Mish i pjekur në saç** – Mish i butë dhe i shijshëm, i gatuar sipas traditës lokale nën prushin e ngrohtë.
- **Byrek me hithra** – Një byrek i shijshëm me barishte të egra, një recetë tipike e Alpeve.
- **Tespište** – Një ëmbëlsirë tradicionale e bërë me miell, sheqer dhe gjalpë, perfekte për të përmbyllur një vakt të pasur.
- **Bulmet organik** – Djathë dhe kos i freskët nga bagëtitë e zonës, një shije autentike që nuk duhet humbur.

Mali i Shkëlzenit dhe rrugëtimi drejt Gjeravicës ofrojnë një eksperiencë të papërsëritshme për të gjithë ata që duan të eksplorojnë natyrën e egër të Shqipërisë dhe Kosovës. Për ata që kërkojnë një aventurë të veçantë, me peizazhe magjepsëse dhe një kulturë të pasur lokale, ky destinacion mbetet një nga më të mirët në Ballkan.

VESHJA TRADICIONALE E HASIT - TRASHËGIMI DHE ELEGANCË E RRALLË

Veshja tradicionale e Hasit është një nga kostumet më të bukura dhe më të pasura të trashëgimisë shqiptare. E veçantë për qëndisjet e saj të hollësishme, simbolet tradicionale dhe kombinimet e ngjyrave, kjo veshje është një dëshmi e kulturës dhe identitetit të krahinës së Hasit, e cila shtrihet midis Shqipërisë dhe Kosovës.

ELEMENTET KRYESORE TË VESHJES

Veshja e grave

Veshja e grave hasiane është ndër më të dalluarat në etnografinë shqiptare. Ajo përbëhet nga disa elemente karakteristike:

- **Xhubleta** – në disa variante të veshjeve të vjetra, është përdorur edhe xhubleta, megjithëse me kalimin e kohës kjo veshje është zëvendësuar me fustanin e gjatë me ornamente të pasura.
- **Këmisha e bardhë** – Një këmishë e gjatë, e qëndisur me motive tradicionale në mëngë dhe jakë.

- **Pështjellaku** – Një copë e gjatë e qëndisur, e cila mbështillet rreth belit dhe mbahet mbi fustanin ose këmishën. Ngjyrat e pështjellakut shpesh janë të kuqe dhe të zeza, duke simbolizuar forcën dhe pasionin.

- **Jelevu** – Një jelek i qëndisur me fije ari ose argjendi, i cili zbukuron veshjen dhe i jep një pamje fisnike.

- **Shamia e kokës** – Gratë mbajnë një shami të qëndisur, shpesh të bardhë ose me motive të kuqe dhe të arta, e cila mbulohet mbi flokët e gërshetuara.

- **Stolitë** – Gratë hasiane përdorin varëse argjendi, monedha të vjetra dhe gjerdanë të punuar me mjeshtëri, të cilat përforcojnë hijeshinë e kësaj veshjeje.

Veshja e burrave

Veshja tradicionale e burrave në Has përmban elemente

që pasqyrojnë burrërinë dhe krenarinë e krahinës:

- **Plisi i bardhë** – Një simbol i pastërtisë dhe identitetit shqiptar.

- **Këmisha e bardhë me mëngë të gjera** – E thjeshtë, por elegante, shpesh e shoqëruar me një jelek të qëndisur.

- **Brez i gjerë me motive tradicionale** – Një shirit i punuar me fije leshi, i cili lidhet rreth belit dhe përdoret për të mbajtur armët e vogla tradicionale.

- **Tirqit** – Pantallona të ngushta të zbukuruara me gajtanë të zinj.

- **Opingat ose këpucët e punuara me dorë** – Të bëra nga lëkura, me qëndisje të vogla në majë.

SIMBOLIKA DHE RËNDËSIA KULTURORE

Veshja e Hasit është më shumë se një mënyrë veshjeje – ajo është një shprehje e identitetit, traditës dhe historisë së popullit të kësaj zone. Qëndisjet dhe motivet shpesh kanë domethënie simbolike, duke pasqyruar natyrën, besimet dhe lidhjen e fortë me tokën dhe familjen.

Edhe sot, veshja tradicionale e Hasit ruhet me krenari dhe përdoret në festa, dasma dhe ngjarje të rëndësishme kulturore, duke mbetur një pjesë e gjallë e trashëgimisë shqiptare.



TAVA E ELBASANIT, NJËRA NGA GATIMET QË DUHET PROVUAR



Në recetat tradicionale shqiptare, tava e Elbasanit është njëri nga ushqimet e rekomanduara për t'u provuar. E përgatitur në mënyrë tradicionale, tava me bazë mishi është e veçantë për nga shija dhe përmbajtja ushqimore e saj.

Receta tradicionale përgatitet kryesisht me mish qengji ose viçi dhe kos të pjekur, përzierje kjo që krijon një kombinim të shijshëm me shumë aromë.

Gatimi zihet në tavë dheu, ndërsa pjekja në furrë të drurit i shton asaj shijen e veçantë të furrës, e cila preferohet nga adhuruesit e mishit të gatuar në mënyrë tradicionale.

PËRBËRËSIT:

- 1 kg mish qengji ose viçi (të prerë në copa);
- 500 g kos;
- 2 lugë gjelle miell;
- 2 lugë gjelle gjalpë;
- 2 kokrra vezë;
- 1 qepë e madhe (e grirë imët);
- Kripë dhe piper sipas shijes;
- 1 lugë çaji rigon ose trumzë (opsionale).

PËRGATITJA:

Përgatitja e tavës nis me zierjen e mishit. Në një enë mishi zihet me kripë deri kur ai të zbutet plotësisht. Pjesa kryesore e tavës është salca e kosit. Ajo përgatitet ndaras nga mishi për t'u bërë bashkë më pas në tavë. Në një tigan kaurdisim qepën me gjalpin deri sa të bëhet e artë, pastaj masës i shtohet miell, i cili kaurdiset deri kur të marrë ngjyrë. Masa pastaj përzihet me ujin e mishit të zier, i cili formon një qull të trashë.

Krahas qullit, në një enë tjetër përzihen vezët me kosin e freskët, të cilat pasi tunden përzihen me qullin e trashë. Në një tavë vendosim copat e mishit të gatuar dhe sipër tyre hedhim salcën me kos.

E fusim në furrë të parangrohur në 180°C për rreth 30-40 minuta, derisa të marrë një ngjyrë të artë në sipërfaqe.

thirr.com



INTERNETI MË I MIRË 5G KOSOVË & EUROPË

AKTIVIZOJE eSIM ONLINE OSE TEK
PIKA NE AEROPORT (TEK DALJA)★

1GB
3,49€
15 DITË

3GB
8,49€
30 DITË

6GB
13,99€
30 DITË

12GB
18,99€
30 DITË

20GB
29,99€
30 DITË★

30GB
39,99€
30 DITË

50GB
99,99€
365 DITË

+80
shtete



UDHËTO PA BRENGA ME PAKOT PALIMIT

19,99 €
3 DITË

29,99 €
7 DITË

44,99 €
30 DITË



GROUP
Blendi

shpejt,
lirë dhe
kualitet

SHTYPSHKRONJË | REKLAMA & 3D | MATERIAL ZYRTAR
MATERIAL SHKOLLOR | RAFTA METALIK | KARRIGE PËR ZYRE

 www.blendi-ks.com

  [blendigroup](https://www.facebook.com/blendigroup)



KATALOGU
MAKINERIVE



KATALOGU
PROMOCIONAL

Scan Me!



LULISHTJA LABI

Jepni jetë kopshtit tuaj!



+ 383 49 777 406



www.lulishtjalabi.com



Magjistrallja Prishtinë-Ferizaj



INVESTIMET NË ENERGJI, MUNDËSIE MIRË PËR BIZNESMENËT

Kosova është njëri nga prodhuesit më të mëdhenj në Ballkan të energjisë nga qymyri, mirëpo prodhimi i energjisë elektrike nuk arrin të përmbushë nevojat e vendit.

Në nivelin strategjik, Qeveria e Kosovës ka paraparë të mbështesë investimet në energji të ripërtëritshme dhe prodhim të energjisë alternative, nga era, uji dhe energjia diellore.

Ekspertët llogarisin se investimet në energji në tregun e Kosovës janë fitimprurëse dhe garantojnë kthim të investimit në afate shumë të shpejta.

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZrRE) e Kosovës e ka miratuar Rregullën Nr. 03/2023 për vetë konsumatorët (prosumatorë) me burime të ripërtëritshme të energjisë, e cila përcakton kushtet dhe procedurat për konsumatorët që dëshirojnë të instalojnë panele solare në shtëpitë e tyre dhe të bëhen prosumatorë. Pra, secili biznes

apo ekonomi familjare ka mundësi të prodhojë energji elektrike të ripërtëritshme për konsum vetjak.

“Prosumatorët” janë konsumatorë që prodhojnë vetë energji elektrike për nevojat e tyre dhe, në disa raste, kanë mundësi të kthejnë tepricat e energjisë në rrjetin e shpërndarjes. Ky model u mundëson konsumatorëve të ulin ndjeshëm faturat e energjisë, të reduktojnë varësinë nga burimet tradicionale dhe të kontribuojnë në uljen e ndotjes së ambientit.

Me ndryshimin e rregullores, ZrRE-ja ka hapur mundësi që edhe nëpër shtëpitë që nuk kanë leje ndërtimore të mund të instalojnë panele solare,



“Prosumatorët” kanë mundësi të kyçen në rrjetin e shpërndarjes, duke përdorur sistemin e matjes neto, i cili u mundëson atyre të kompensojnë energjinë e prodhuar dhe të ulin faturat. Me rritjen e çmimeve të energjisë elektrike, investimi në energji diellore mund të sjellë kursime të konsiderueshme për qytetarët dhe bizneset.

Për t'u bërë “prosumator”, konsumatorët duhet të aplikojnë në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë. Në aplikim kërkohen disa dokumente, që në masë të madhe plotësohen nga kompania e kontraktuar për instalimin e paneleve solare.

Përfaqësuesit e ZRrE-së e kanë përmendur se një nga mundësitë që bizneset të ulin faturën e rrymës është investimi në panele solare, që u mundëson atyre të prodhojnë energji për vetëkonsum. Në një bashkëbisedim të mbajtur më 17 mars 2025, ndërmjet Zyrës së Rregullatorit të Energji (ZRrE) dhe përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës, u diskutua procesi i liberalizimit të tregut të energjisë dhe ndikimi i tij në bizneset e mesme. Kryesuesi i Bordit të ZRrE-së, z. Ymer Fejzullahu, theksoi rëndësinë e këtij procesi për rritjen e konkurrencës dhe krijimin e një ambienti të favorshëm për investime.

duke e bërë procesin më të thjeshtë.

PËRFITIMET E ENERGJISË SOLARE

Burim i pafund dhe i rinovueshëm – Dielli është një burim i pashtershëm energjie, duke siguruar një alternativë afatgjatë ndaj karburanteve fosile.

Reduktimi i faturave të energjisë – Familjet dhe bizneset që investojnë në panele solare mund të ulin ndjeshëm shpenzimet për energji elektrike, madje edhe të prodhojnë energji të tepërt për ta shitur në rrjetin elektrik.

Mbrojtja e mjedisit – Panelet solare nuk prodhojnë gazra serë ose ndotje ajri, duke ndihmuar në uljen e ndikimit negativ ndaj mjedisit.

Kosto e ulët e mirëmbajtjes – Panelet solare kanë një jetëgjatësi të madhe (deri në 25-30 vjet) dhe kërkojnë shumë pak mirëmbajtje.

Panelet solare mund të instalojnë në:

- Shtëpi private, për të siguruar energji për ndriçim, pajisje elektrike dhe ngrohje uji.

- Biznese, për të ulur kostot operative dhe për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm.
- Farma diellore të mëdha, për të prodhuar energji në shkallë industriale dhe për ta shpërndarë në rrjetin kombëtar.
- Infrastruktura publike, si shkolla, spitale dhe objekte qeveritare, për të reduktuar varësinë nga energjia konvencionale.



Mundësitë e investimeve në energji të ripërtëritshme në Kosovë

Kosova po bën hapa konkretë drejt diversifikimit të burimeve të energjisë, duke ofruar mundësi të reja për investorët që synojnë të zhvillojnë projekte të mëdha në sektorin e energjisë së ripërtëritshme. Kosova ka potencial të madh për shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme, veçanërisht në energjinë diellore dhe atë të erës. Me një numër të madh të ditëve me diell gjatë vitit dhe lokacione të favorshme për parqe me erë, vendi ofron kushte optimale për zhvillimin e projekteve energjetike.

Qeveria e Kosovës ka hartuar një kornizë ligjore dhe rregullatore që u mundëson investorëve të mëdhenj të marrin pjesë në ankande për ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike. Në dy vitet e fundit, Kosova ka organizuar ankande për ndërtimin e impianteve të mëdha për energjinë e ripërtëritshme në fushën e energjisë së erës dhe atë diellore. Me trendin aktual të zhvillimit, Kosova pritet të organizojë ankande të reja në vitet e ardhshme për të rritur më tej kapacitetet e energjisë së pastër. Për investorët që dëshirojnë të hyjnë në tregun e energjisë së ripërtëritshme, kjo është një mundësi e artë për të kontribuar në transformimin e sektorit energjetik të Kosovës dhe për të përfutur nga një treg në zgjerim.

Synimet e Kosovës për energjinë e ripërtëritshme

Kosova ka përcaktuar objektiva ambicioze në Strategjinë e Energjisë 2022-2031,

duke synuar të rrisë përqindjen e energjisë së ripërtëritshme në miks energjetik të vendit. Një nga qëllimet kryesore është rritja e kapacitetit të instaluar nga burimet e pastra, me projekte të reja për energjinë e erës, diellore dhe hidroenergjinë.



Një aspekt tjetër i rëndësishëm i strategjisë është reduktimi i varësisë nga lëndët djegëse fosile, veçanërisht qymyri, i cili aktualisht përbën burimin kryesor të prodhimit të energjisë në vend. Kalimi drejt energjisë së pastër do të ndihmojë në përmbushjen e objektivave klimatike dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Për të lehtësuar tranzicionin, Kosova synon të zgjerojë rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes, duke përmirësuar infrastrukturën për integrimin e kapaciteteve të reja të ripërtëritshme në sistemin energjetik.

Një tjetër prioritet është përfshirja e sektorit privat në



zhvillimin e projekteve të mëdha energjetike, duke krijuar skema mbështetëse dhe stimuj fiskalë për të tërhequr investorët e huaj dhe vendorë në këtë sektor.

Energjia diellore është një nga burimet më të pastra dhe më të rinovueshme të energjisë në botë. Përdorimi i paneleve solare për prodhimin e energjisë elektrike po bëhet gjithnjë e më i zakonshëm, duke ofruar një



alternativë të qëndrueshme dhe ekologjike ndaj burimeve tradicionale të energjisë.

Si funksionojnë panelet solare?

Panelet solare përbëhen nga qeliza fotovoltaike (PV), të cilat shndërrojnë dritën e diellit në energji elektrike përmes një procesi të quajtur efekti fotovoltaiik. Ky proces ndodh kur grimcat e dritës (fotonet) godasin qelizat solare dhe nxisin lëvizjen e elektroneve, duke krijuar energji elektrike të drejtpërdrejtë (DC). Kjo energji më pas konvertohet në rrymë alternative (AC) përmes një inverteri, duke e bërë të përdorshme për pajisjet elektrike.





MUNDËSITË PËR INVESTIME NË KOMPLEKSIN “VJENA” NË GOLEM

Në njërën nga zonat më të bukura të bregut të Golemit, kompania lidere e ndërtimit, “Bonita Konstruksion”, ka nisur ndërtimin e kompleksit të apartamenteve “Vjena”.

Indërtuar me një koncept të ri arkitektonik, kompleksi ofron mundësi për apartamente familjare të madhësive të ndryshme. Kompleksi garanton qasje në zonën turistike dhe është shumë afër plazhit të bukur të Golemit.

Arkitektët kanë planifikuar ndërtimin e objektit për të mundësuar që nga tarracat e tyre apartamentet të kenë pamje nga deti. Ky stil ndërtimi krijon mundësinë që vizitorët të shijojnë gjatë gjithë kohës pamjen që nga lindja deri te perëndimi i diellit.

Kompleksi do të ketë parking nëntokësor dhe infrastrukturë përcjellëse, si dyqanet dhe restorantet brenda kompleksit.

Hapësirat e ndërtuara variojnë nga metrat katrorë dhe kërkesat e klientëve, ndërsa në negociatat me kompaninë klientët mund të paguajnë për blerjen e apartamentit, duke filluar nga 40% e vlerës së

investimit. Në negociata me zyrën e shitjes për klientët që vendosin të kryejnë pagesën e plotë të apartamenteve në avancë.

Mundësia e qiradhënies së banesës së blerë

Në kompleksin “Vjena” mundësia e qiradhënies së apartamenteve është e lartë për shkak të fluksit të madh të turistëve në zonën e Golemit. Objektet

- Kompleksi “Vjena” - në zemër të Golemit
- Afër detit dhe me dizajn modern
- Ideal për jetesë dhe investim turistik
- Mundësi qiradhënieje me kthim të garantuar



në ndërtim në kompleksin “Bonita” kanë mundësi të adaptimit të hapësirave për nevojat specifike të klientëve. Brenda mureve, kompania mund të krijojë ndërhyrje për të përshtatur kërkesat e klientëve, për të

rritur apo zvogëluar hapësirat e dhomave. Bashkë me këto klientët, mund të vendosin të përdorin materiale specifike në renovimin e hapësirave të brendshme të objektit.

Çfarë dimë për zonën e Golemit?

Kryeministri Edi Rama, në një deklaram gjatë muajit mars, ka vendosur vëmendjen në trendët e rritjes së investimeve në patundshmëri në Shqipëri. Ai ka inkurajuar qytetarët që të investojnë në pronë, të cilat, sipas tij, do të rrisin vlerën menjëherë pasi vendi të anëtarësohet në Bashkimin Evropian.

“Kini parasysh që në momentin që ne hyjmë në BE, të gjitha pronat do të pësojnë rritje çmimi, dyfish menjëherë, siç ka treguar historia e të gjitha vendeve që kanë hyrë para nesh”, ka thënë Rama. Zona e Golemit në Shqipëri është një destinacion turistik i njohur, i cili ofron një kombinim të bukur të natyrës dhe plazheve. Ja disa nga veçoritë kryesore të kësaj zone: Plazhi i Golemit - Ky është një plazh i njohur me rërë të artë dhe ujë të pastër, i përshtatshëm për turizëm familjar. Plazhi ka infrastrukturë të mirë për pushuesit, duke ofruar mundësi për aktivitete të ndryshme si not, sporte ujore, dhe relaksim në diell.

Golemi ndodhet rreth 6 kilometra në jug të Durrësit, duke e bërë atë një mundësi të shkëlqyer për ata që duan të shijojnë një pushim të qetë, por afër qytetit dhe të gjitha mundësive që ai ofron. Ndodhet gjithashtu afër Rrugës Kombëtare, duke u mundësuar një lidhje të shpejtë me qytetet e tjera të Shqipërisë. Zonat e Golemit kanë kaluar në një periudhë zhvillimi, me ndërtimin e hoteleve, restoranteve, dhe komplekseve turistike. Kjo ka bërë që zona të jetë më tërheqëse për turistët, duke ofruar kushte më të mira dhe mundësi për relaksim.



- Pagesë me këste & avantazhe për pagesën e plotë
- Bëhuni pronar me vetëm 40% pagesë fillestare
- Për pagesën e plotë në avancë - përfitime ekskluzive
- Kontaktoni për më shumë informacion!
- +355 69 238 6456 (Thirrje & WhatsApp)
- Na vizitoni për të parë nga afër projektin dhe për të siguruar apartamentin tuaj!



FERIDE RUSHITI, AKTIVISTJA E DREJTAVE TË NJERIUT E NOMINUAR PËR ÇMIMIN NOBEL PËR PAQE

Karriera e Feride Rushitit është një rrugëtim i përkushtuar për trajtimin e viktimave të krimeve të luftës dhe puna e saj me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve (QKRMT) është themeli që e ka bindur deputetin e Parlamentit suedez, Magnus Jacobsson, t'i drejtohet Komitetit të Institutit Norvegjez të Nobelit për ta nominuar Rushitin për Çmimin Nobel për Paqe.

Rushiti është njëra prej aktivisteve të shquara të shoqërisë civile në Kosovë, e cila ka ofruar mbështetje të vazhdueshme për viktimat e luftës dhe pasojat pas saj.

Në letrën drejtuar Institutit Norvegjez të Nobelit, deputeti Jacobsson ka theksuar se ky vendim është marrë për të njohur kontributet e jashtëzakonshme të Feride Rushitit dhe QKRMT-së në avancimin e të drejtave të njeriut, dinjitetit të të mbijetuarve dhe shërimin e plagëve të luftës për komunitetet.

Çmimi Nobel për Paqe synon të vlerësojë individë që kontribuojnë në paqe, drejtësi dhe pajtim. Feride Rushiti dhe QKRMT-ja e personifikojnë këtë ideal përmes angazhimit të tyre të përhershëm për mbështetjen e personave më të cenueshëm, duke shëruar plagët e konflikteve dhe duke

ndërtuar një bazë për paqe të qëndrueshme në Kosovë dhe përtej”, shkruan Jacobsson.

Në një konferencë për media, pas këtij nominimi, Rushiti theksoi se ky është një vlerësim për kauzën e të mbijetuarve të dhunës seksuale, një kauzë që ka filluar të merret në konsideratë që nga viti 1998. “Shpresoj se ky nominim do të nxjerrë Kosovën në një situatë ndërkombëtare, ku zëri i të mbijetuarve të dhunës seksuale do të dëgjohet globalisht”, ka theksuar Rushiti.

Feride Rushiti dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) janë nominuar për Çmimin Nobel për Paqe për vitin 2025.

QKRMT-ja, e themeluar nga Rushiti në vitin 1999, ka ofruar trajtim dhe rehabilitim për viktimat e torturës në Kosovë. Po ashtu, kjo qendër promovon respektimin e



të drejtave të njeriut për të gjitha etnitë që jetojnë në Kosovë, si dhe përpjekjet për parandalimin dhe çrënjosjen e torturës dhe të gjitha formave të keqtrajtimit.

“ Në letrën drejtuar Institutit Norvegjez të Nobelit, Jacobsson thekson se Rushiti ka dedikuar karrierën e saj adresimit të efekteve shkatërruese të torturës, dhunës seksuale dhe mizorive të tjera të luftës. QKRM-ja ka ofruar mbështetje mjekësore, psikologjike dhe ligjore për mijëra të mbijetuar, duke siguruar që zërat e tyre të dëgjohen dhe nevojat e tyre të përmbushen.

“Avokimi novator i Rushitit për njohjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës ka transformuar diskursin kombëtar në Kosovë. Përpjekjet e saj të pareshtura kanë çuar në krijimin e një kornize ligjore që i njeh këta individë si viktime civile të luftës, duke u mundësuar atyre qasje në reparacione. Kjo arritje historike, e arritur më 2017, ka sjellë dinjitet dhe mbështetje financiare për shumë të mbijetuar dhe është shpresë për drejtësinë pasluftës në të gjithë botën,” ka shtuar ai.

Gjithashtu, Jacobsson vlerëson se Rushiti ka pasur arritje të mëdha edhe në trajtimin e të burgosurve dhe të ndaluarve, duke avancuar standardet ligjore dhe etike në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Në vitin 2018, Rushiti u nderua me Çmimin për Guximin e Gruas nga sekretari amerikan i Shtetit, për ndikimin e saj të madh në jetën e të mbijetuarve dhe për rolin e saj si udhëheqëse globale në avokimin për të drejtat e njeriut.

Në vitin 2020, deputeti suedez, Magnus Jacobsson, kishte nominuar Kosovën, Serbinë dhe Shtetet e Bashkuara për Çmimin Nobel për Paqe, për përpjekjet e tyre në arritjen e një marrëveshjeje paqeje mes Kosovës dhe Serbisë. Po ashtu, për këtë çmim ishin nominuar edhe udhëheqësit e Kosovës, Serbisë dhe Bashkimit Evropian, në vitin 2013, dhe presidenti i ndjerë i Kosovës, Ibrahim Rugova, në vitin 1996.

KUSH MUND TË BËJË NOMINIME PËR ÇMIMIN NOBEL PËR PAQË?

“ Sipas statutit të Fondacionit të Nobelit, nominimet për Çmimin Nobel për Paqe mund të bëhen nga anëtarë të parlamenteve dhe qeverive kombëtare të shteteve sovraane, presidentët, anëtarët e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit në Hagë. Po ashtu, nominime mund të bëjnë edhe anëtarët e Institutit Ndërkombëtar të Dritës, profesorë universitarë, laureatë të Çmimit Nobel për Paqe, anëtarë aktualë të Komitetit Norvegjez të Nobelit dhe ish-këshilltarë të këtij komiteti. Pas nominimeve, Komiteti bën përzgjedhjen e kandidatëve të kualifikuar dhe zgjedh fituesin.



ALFABETIZIMI NË GJUHËN SHQIPE I FËMIJËS NË DIASPORË DHE ROLI I PRINDIT

(Udhëzime të mësuesit për prindin për ta ndihmuar procesin)

1. Për konceptin

Çka është alfabetizimi?

Në rrafshin teorik, alfabetizimi përcaktohet si proces mjaft kompleks i mësimi të shkrimit në një apo më shumë gjuhë. Sigurisht që për shumë arsye alfabetizimi fillimisht në gjuhën amtare i ka përparësitë e dukshme, por në realitetin aktual të diasporës shqiptare është mjaft vështirë të realizohet. Vështirë, sepse fëmijët shqiptarë sot në diasporë rriten, shkollohen e zhvillohen në një ambient kryesisht dy e mbase edhe më shumë gjuhësorë dhe kulturorë. Prandaj, procesin e përcjellin dhe e diktojnë rrethana të ndryshme, ku rolet e familjes, kopshtit, shkollës etj., jo gjithmonë duken të koordinuara mirë. Tashmë është e qartë se procesi të shumtën fillimisht ndodh në gjuhën e vendit pritës ose, ta quajmë kushtimisht, gjuhën e shkollës formale (zyrtare), e cila gjithnjë e më tepër po shfaqet si gjuhë e parë. Është shumë me interes që shkrim-leximi, respektivisht alfabetizimi, të kuptohet si proces që nis të zhvillohet prej moshës së fëmijërisë së hershme (0-5 vjeç), duke kaluar nëpër faza të mëvonshme në kopshte (5-6 vjeç), familje a shkollë e për të arritur deri në nivelin e kompetencës së duhur. Shihet që pjesëmarrja nis me rolin e familjes (prindit), të kopshtit, të shkollës e të faktorëve të tjerë të botës së komunikimit, tashmë gjithnjë e më e pasur me forma e mjete të shumta të tij. E theksova komunikimin, sepse alfabetizimi në të vërtetë është pasaporta ose dera hyrëse në botën e madhe të komunikimit njerëzor, që zhvillohet para së gjithash përmes gjuhës (fjalëve e shkronjave). I gjithë procesi zhvillohet me ndihmën e mjeteve, mediumeve e të materialeve mësimore të llojeve të ndryshme, si në shtëpi e familje, si në kopsht e në shkollë, si gjetiu dhe, për fat të mirë, sot më shumë se kurrë janë të mundshme, jo të shtrenjta dhe të arritshme.

Alfabetizimi, si proces i zhvillimit të aftësive të shkrimit e të leximit,



më specifikisht përfshin njohjen e tingujve dhe të shkronjave të një gjuhe dhe mundësinë që ato ofrojnë për të ndërtuar fjalë, përfshin leximin si një proces kompleks, me qëllimin kryesor për ta kuptuar tekstin si strukturë e ndërtuar brenda ligjësi e rregullave gramatikore, pastaj shkrimin dhe koherencën e tij, po ashtu, si proces kompleks përmes përdorimit të fjalëve brenda rregullave gramatikore, kompetencën për ta kuptuar, analizuar e interpretuar qartas, të plotë dhe në kontekste të ndryshme informatën e lexuar. Në rrafshin e zhvillimit emocional e social të fëmijës, alfabetizimi zhvillon e forcon veçmas vetëbesimin dhe rolin personal në marrëdhëniet shoqërore, duke i ofruar atij (fëmijës) më shumë liri, mendim e gjykim të pavarur dhe, rrjedhimisht, më shumë sukses në jetën e përditshme. Një rol vendimtar e ushtron posaçërisht në procesin e zhvillimit identitar e kulturor të fëmijës (gjuha e kultura e prejardhjes, identiteti kombëtar, etniciteti - vetëdija për përkatësinë).

Nga një perspektivë tjetër, duhet të thuhet se alfabetizimi nënkupton zhvillimin e kompetencës së duhur për të mësuar, për të nxënë. Bile, në raport me shkollën aktuale shqiptare dhe rezultatet që kanë dëshmuar testimet e matjet e ndryshme deri ato të viteve të fundit të PISA-s, kjo kompetencë lë shumë për të dëshiruar dhe dështimi e ka fillin në keqndërtimin e vetë sistemit, të doktrinës dhe rrjedhimisht në vetë reduktimin e konceptit të alfabetizimit. Një sistem, i cili tradicionalisht e aksidentalisht në bazë e ka mësimin përmendsh, nuk ofron mundësi të

zhvillimit të drejtë e të plotë as në fushë të alfabetizimit. Ai i zë frymën zhvillimit të mendimit e gjykit të lirë e krijues të fëmijës. Bile, kur jemi të mësimi shqip në diasporë, po bëj një ndërkallje duke ua kujtuar jo vetëm prindërve paradoksin që e hetojmë jo rrallë në komunikimet tona kulturore e arsimore (në shkollë, në familje, në programe publike, në gara e konkurse të dijes etj.), ku fëmijët tanë i hasim (jo rrallë edhe i detyrojmë për

kënaqësinë e të rriturit, qoftë ai prind, mësues etj.) duke lexuar, recituar a deklamuar tekste në gjuhën shqipe, të cilat mjerisht, duke mos qenë të përshtatura me moshën dhe kompetencat e tyre paraprake gjuhësore, nuk i kuptojnë fare. Bile, jo rrallë tingëllojë edhe si triviale apo edhe shpirtërisht deri 'represive' në një masë. Kësisoj, në vend të dashurisë për gjuhën amtare, e thellojmë distancën me të dhe rrjedhimisht e zbehim funksionin e saj (gjuhës amtare) në zhvillimin identitar (kombëtar e kulturor) të fëmijës.

2. Alfabetizimi në gjuhën amtare dhe në sa më shumë gjuhë

Në realitetin demografik shqiptar, ku pothuajse gjysma e shqiptarëve tashmë, për fat të keq, jetojnë fizikisht jashtë atdheut, procesi i alfabetizimit, i lidhur ngushtë edhe me ndërgjegjen kulturore e kombëtare, fiton shumë në peshë. Fakti që fëmijët e shqiptarëve mësimin në institucionet shkollore e ndjekin në gjuhën e vendit pritës, nënkupton se edhe alfabetizimi i tyre zhvillohet kryesisht në këtë gjuhë. Në të vërtetë vetëm në pak vende e sisteme

arsimore shtetesh të ndryshme tashmë zhvillohet edhe mësimi i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare, i njohur si mësimi i gjuhës dhe i kulturës së prejardhjes ose, siç jemi mësuar ta quajmë, Shkolla Shqipe, kështu që, shikuar në përgjithësi, pjesëmarrja apo përfshirja në alfabetizim të fëmijës fillimisht ose paralelisht me gjuhën e vendit edhe në gjuhën amtare është shumë e vogël.

Ndërkaq, për ndërgjegjen tonë kulturore e kombëtare, për kompetencën tonë profesionale (mësuesi) e familjare (prindi) gjithnjë mbetet sfidë reale kërkimi e gjetja e modalitetit optimal të alfabetizimit të fëmijës në gjuhën amtare. Së këndejmi, përkundër vështirësive, ai duhet të ndodhë dhe është i domosdoshëm, qoftë fillimisht, qoftë paralelisht me gjuhën tjetër, qoftë edhe më vonë.

Natyrisht që sot në botë studime të shumta ndërdisiplinare i mësojnë fort teorinë së rolit të parë që ka alfabetizimi në gjuhën amtare dhe ky rol lidhet me shumë faktorë; personalë, emocionalë, socialë, kulturorë, kombëtar, identitarë etj. Nga kjo perspektivë duhet afirmuar e mbështetur sa më shumë që të jetë e mundur nga të gjithë faktorët e shkollës zhvillimin e mësimi të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare brenda sistemit formal arsimor të vendit, në mënyrë që edhe alfabetizimi të ndodhë së paku paralelisht dhe i koordinuar në të dy gjuhët (amtare dhe të vendit pritës).

Janë të njohura përparësitë e alfabetizimit në gjuhën amtare. Ato fillimisht lidhen me ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar (gjuha amtare shqipe e kultura shqiptare me të gjithë përbërësit e saj), me zhvillimin e lidhjeve dhe të komunikimit me familjen dhe rrethin e gjuhës së njëjtë dhe të rolit që ka kjo lidhje në rrafshin emocional e shoqëror, në zhvillimin e forcimit të vetëbesimit që të krijon njohja e gjuhës amtare dhe vlera e veçantë e saj si pasuri personale e kombëtare. Më tej, shkenca, po ashtu, ka konstatuar se alfabetizimi fillimisht në gjuhën amtare përbën një resurs shumë të çmuar dhe ndikon në lehtësimin e përvetësimit të gjuhës tjetër apo gjuhëve të tjera (ndërveprimi gjuhësor).

Ndërkaq, alfabetizimi në përgjithësi, qoftë ai fillimisht në gjuhën amtare, qoftë në gjuhën tjetër të vendit apo edhe në gjuhët e tjera, është faktor bazë i zhvillimit

të aftësive njohëse dhe krijuese të fëmijës (zhvillimi kognitiv), e faktorizon fëmijën në nivel të subjektivitetit të lirë e të pavarur me ndjenjën e barazisë, të përgjegjësisë e të pjesëmarrjes, e afirmon dhe e zhvillon kultivimin e pranimin e diversitetit gjuhësor e kulturor si vlera njerëzore, e afirmon dy e shumëgjuhësinë si resurs modern intelektual shumë të çmuar etj.

3. Kompetenca ime si prind në këtë proces

E tash po i kthehemi familjes e prindit që, ndër faktorët e shumtë, përveç institucioneve kopsht ose shkollë e që zakonisht iu referohen kompetencës shtetërore (të shtetit pritës dhe të shtetit të prejardhjes, i cili, megjithatë, vështirë të zgjohet nga letargjia ku ka rënë, sic!), kanë rol të veçantë. Dija e vjelë nga më të diturit e fushës (baza shkencore) dhe përvoja personale (empirike) më japin guximin që më poshtë, sipas ambienteve e të rolit të prindit, të rekomandoj disa udhëzime.

a) Në kuadër të Shkollës Shqipe dhe rrethit shoqëror

- Dëshmoje ndërgjegjen tënde kulturore e kombëtare për të bërë të gjitha të mundshmet e përfshirjes së fëmijës në mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, sepse vetëm në shkollë alfabetizimi zhvillohet brenda standardeve e përkujdesjes profesionale;
- Ndihmoje shkollën me praninë e pjesëmarrjen tënde në të gjitha fushat e nevojshme, duke u lidhur ngushtë më mësuesin/en në të gjitha veprimtaritë shkollërore e jashtëshkollërore të nevojshme në funksion të suksesit të fëmijës;
- Inkurajoje dhe mundësoja fëmijës tënd komunikimin me rrethin shoqëror lokal e më gjerë të origjinës së njëjtë (shqiptare) dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë e ndryshme kulturore, sportive etj;
- Mbështete fëmijën tënd në detyrat e shtëpisë dhe mbaj lidhje të vazhdueshme me mësuesin/en;
- Inkurajoje fëmijën për të mirat e gjuhës amtare dhe edukoje me krenarinë e përkatësisë ndaj gjuhës amtare e kulturës shqiptare;
- Edukoje e inkurajoje fëmijën me pranimin e respektimin e tjetrës, të ndryshmes (qoftë gjuhë,

qoftë kulturë etj.), me praninë e pjesëmarrjen në veprimtari të ndryshme në funksion të kompetencës ndërkulturore, sepse e pasurojnë edhe vetë konceptin e Shkollës Shqipe dhe vetëdijen kulturore kombëtare;

b) Brenda familjes

- Pa marrë parasysh a e ndjek apo jo fëmija yt Shkollën Shqipe, krijo ambient familjar të qetë e komod të komunikimit në gjuhën shqipe, duke inkurajuar vazhdimisht leximin e shkrimit dhe format e tjera të shumta të komunikimit, përfshirë edhe ato të njohurat hipermediale e deri te intelgjencia artificiale (Chat gpt);
- Komunikimi familjar dhe në rreth të përkatësisë së njëjtë në gjuhën shqipe të ngrihet në nivel të krenarisë e vetëbesimit për rrënjën, prejardhjen;
- Blej e siguro libra e materiale të ndryshme mësimore deri në nivel të ndërtimit të bibliotekës apo të mediatekës familjare, ku të përshtatura e të përdorura sipas moshës kanë rol të rëndësishëm në alfabetizimin e fëmijës në gjuhën shqipe (prej lodrave e lojërave, ilustrimeve, animacioneve, këngëve, paraabetares, abetares, librave të leximit e deri te librat me krijime letrare autoriale të zgjedhura me kujdes, botime të krijimtarisë letrare gojore, materialeve hipermediale artistike, muzikore etj.);
- Edukoje dhe inkurajoje fëmijën për lidhje e komunikim me rrethin e tij gjuhësor të prejardhjes së njëjtë në komunitetin lokal e deri tek ato me rrethin familjar e më gjerë në Atdhe;
- Biseda (besa edhe shkrime) të vazhdueshme tematike për gjuhën, kulturën, Atdheun e vizitat e pushimet e mirëplanifikuara paraqesin nxitje e frymëzim për edukim identitar;
- Nëse e ke larg shkollën ose për arsye të shumta e të ndryshme fëmija yt nuk e ndjek dot atë, kurrë mos harro (dhe këtë lidhe edhe me përvojën personale) se fëmija mendon në gjuhën që e di më mirë, bile edhe ëndrrat i sheh zakonisht në gjuhën që e di më mirë, ndërkaq, duke qenë se për shqiptarët jo rastësisht gjuha është vetë identiteti kombëtar.



Për shëndet të mirë!

Shërbimet:

- Laboratori i biokimisë dhe hematologjisë
- Laboratori i mikrobiologjisë
- Mjekësi familjare
- Pediatri
- Nefrologji
- Psikologji
- Kardiologji
- Endokrinologji
- Pulmologji
- Ortopedi
- Urologji
- Radiologji (perfshirë CT, radiografi)
- Kirurgji e përgjithshme

Prishtinë
Prizren
Suharekë
Gjilan
Mitrovicë
Ferizaj

Qendra Tregtare Dardha	+383 48 32 31 30
Rr. Wesley Clark,	+383 48 52 00 08
Rr. Skënderbeu	+383 48 52 00 04
Rr. 7 shtatori	+383 49 52 01 25
Rr. Minatorët e Trepçës	+383 48 52 00 05
Rr. Uran Tinova	+383 48 52 05 25

Olive Clinic kujdeset për shëndetin tuaj!



PROGRAMET ATRAKTIVE PËR STUDENTËT NGA **EVROPA** **NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS**

Në hapat e zhvillimit të vet, Universiteti i Prishtinës ka nisur programet e studimit në gjuhën angleze për studentë nga Evropa që dëshirojnë të studiojnë në Prishtinë.

Programi i drejtësisë tranzicionale është një nga degët e rëndësishme në Fakultetin Juridik, i cili ka ngjallur interesim për studentë nga disa vende të botës.

Weronika Knowska është studente nga Polonia. Ajo është njëra nga gjashtë studentët ndërkombëtarë që po studiojnë në programin master të Fakultetit Juridik të UP-së “Të drejtat e njeriut, e drejta penale ndërkombëtare dhe drejtësia tranzicionale”, i cili ligjërohet në gjuhën angleze.

Kjo nuk është hera e parë që 27-vjeçarja nga Polonia po qëndron në Prishtinë. Ajo ka punuar në

kryeqytetin kosovar me njerëzit e saj që nga viti 2022 dhe banon në një apartament me qira në lagjen Tophane të kryeqytetit.

Knowska ka studiuar marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin e Varshavës në Poloni, pastaj ka studiuar përmes programit Erasmus një vit në Athinë të Greqisë. Ajo ka një titull master në marrëdhënie ndërkombëtare, është hulumtuese dhe ka shtatë vjet që punon në sektorin joqeveritar me refugjatë dhe të rinj. Tani është duke specializuar në dezinformimin rreth migrimit.

Knowska kishte kuptuar për mundësinë që të studiojë master në UP sa kishte qenë duke udhëhequr një trajnim të OJQ “Youth Initiative of Human Rights” në Prizren, i cili kishte të bënte me shkëmbimet ndërmjet serbëve dhe kosovarëve.

“Duke punuar këtu, në Kosovë, e kam kuptuar se mund të kem njohuri praktike kur bëhet fjalë për njerëz të ndikuar nga lufta, por çka mungon në karrierën time akademike, përvojën time akademike, janë njohuritë për të drejtën penale ndërkombëtare, si dhe më shumë njohuri teorike në drejtësi tranzicionale”, ka thënë Knowska.

Programi i Fakultetit Juridik, sipas Knowskas, është



në një vend ku mund të shohësh moderimin e konfliktit dhe proceset e drejtësisë tranzicionale.

Për Weronikan “koha në Ballkan shkon më ngadalë sesa në Evropën Perëndimore”. Ajo thotë se për shumë gjëra duhet të presin më shumë ose duhet ta forcojnë veten me durim. Krahasuar me mënyrën e studimit në Universitetin e Varshavës, Knowska e vlerëson më shumë atë të UP-së.

“Kur flasim për përmbajtjen, unë jam shumë e kënaqur, pasi në Poloni, po ashtu edhe në Greqi, studimet dhe procesi i mësimi bazohen më shumë në ligjëratë, përderisa këtu më shumë bazohen në bisedë dhe për mua, si person që vjen nga sistemi joformal i edukimit, është diçka shumë e rëndësishme, sepse për të mësuar ne në fakt duhet të komunikojmë me njëri-tjetrin”, tha Knowska.

Ajo i kishte takuar kosovarët më parë dhe kishte dëgjuar se Kosova është një vend i bukur, vend rinor dhe shumë mikpritës. Kurse, njerëzve të saj sigurohet t’u tregoj se nuk ka më luftë në Kosovë.

“Por, kur flas me njerëz në Poloni apo në shtete të ndryshme, ose kur shoqëria më vizitojnë këtu, p.sh. për natën e Vitit të Ri shokët e mi erdhën këtu nga Hungaria dhe Italia dhe familjet e tyre, ishin të tmerruar se po vinin në një zonë lufte, sepse duket sikur të ‘90-tat kanë ngecur shumë në perspektivën perëndimore për Kosovën dhe duket sikur ka ende luftë në Kosovë”, ka treguar Knowska.

Për literaturën në Fakultetin Juridik të UP-së, Knowska thotë se nuk kanë probleme, pasi shumica e librave janë në gjuhën angleze dhe, sipas saj, edhe ligji në Kosovë është në gjuhën angleze, kështu që e konsideron si shumë të qasshëm.

“Çka kam pasur problem është se dua shumë ta mësoj gjuhën shqipe dhe është shumë e vështirë të gjenden burime, për ta praktikuar dhe mësuar diçka”, tha Knowska.

Ajo thotë se do t’u rekomandonte shoqërisë së saj të vinin në Kosovë, jo vetëm për të studiuar. Sipas saj, Kosova është një vend i përballueshëm





sa i përket aspektit financiar për të ardhurit nga shtetet e BE-së.

“Për personat që do ta konsideronin këtë program, mendoj se çka do të ishte po ashtu e rëndësishme është se është shumë fleksibil dhe nuk ke nevojë të heqësh dorë në karrierën tënde për një vit dhe ta pezullosh për të qenë këtu. Ne zakonisht kemi orë mësimi të qasshme për njerëzit që kanë punë ditore”, ka shtuar Knowska.

Përveç këtij programi, në të cilin studion Knowska, Avni Puka, dekan i Fakultetit Juridik në UP, ka thënë se në mandatin e tyre të menaxhmentit e kanë edhe programin tjetër në gjuhën angleze - “Studime të avancuara evropiane”.

Sipas Pukës, në programin “Të drejtat e njeriut, e drejta penale ndërkombëtare dhe drejtësia tranzicionale” janë edhe 20 studentë vendorë, kurse të angazhuar 10 profesorë vendorë e 15 ndërkombëtarë, nga universitete prestigjioze.

Studentët në këtë program përfitojnë bursë mujore në vlerë 500 euro në muaj, akomodim në konvikt pa pagesë, praktikë dhe një deri dy aktivitete studimore jashtë Kosovës.

“Meqenëse jemi vend i dalë nga lufta, ka qenë si detyrim yni që në rolin nga perspektiva akademike ta adresojmë të kaluarën dhe një hap të parë ne e kemi bërë me këtë program master, i cili është që dy vjet i akredituar”, ka thënë Puka.

Përmes programit master, Puka tha se synojnë që Fakultetin Juridik e UP-së, por edhe Kosovën, ta bëjnë si referencë të studimit dhe hulumtimit të fushës së drejtësisë

tranzicionale. Ai ka treguar se janë në komunikim intensiv me shumë partnerë për krijimin e Qendrës për Studimin e Gjenocidit, Holokaustit dhe Drejtësisë Tranzicionale.

Në përmbajtjen e programit, përveç drejtësisë tranzicionale, Puka ka treguar se përfshihen: krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, gjenocidit, jurisprudence e gjykatave ndërkombëtare për krimet kundër të drejtës ndërkombëtare, shkelja e rëndë e të drejtave të njeriut.

Në këtë program vitin e kaluar kanë studiuar 10 studentë ndërkombëtarë të rregullt, nga Serbia, Spanja, Turqia dhe pjesa tjetër nga Afrika: Gana, Egjipti, Sudani Jugor, Nigeria, ndërsa këtë vit Puka thotë se studentët janë nga Franca, Holanda, Polonia, Rumania, Maldivet dhe Ishujt e Australisë.

Cilësia e studimeve

Universiteti i Prishtinës është universiteti më i vlerësuar në trevat shqiptare nga vlerësuesi i universiteteve Webometriks. Ky regjistër e rendit Universitetin e Prishtinës si më cilësorin në trevat shqiptare (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi). Në renditjen e janarit të vitit 2025, UP ndodhet në vendin e 2540 të këtij vlerësimi, ndërsa universitetet e tjera janë prapa UP-së. Shumica e programeve studimore në UP janë në gjuhën shqipe dhe literatura është në gjuhën shqipe. Programet profesionale, si ai i Mjekësisë, zhvillohen në qendra spitalore dhe krahas studimit studentët zhvillojnë aftësimin profesional praktik.

Studimet në UP janë pa pagesë, ndërsa për studentët garantohen edhe shujta ushqimore dhe qëndrim në kampusin universitar, i cili ka një kosto të lirë ekonomike.



KËNGËT E DASHURISË QË NGJALLIN NOSTALGJI PËR QYTETET E KOSOVËS

Vargjet e interpretuara nga mjeshtrit e muzikës shqiptare janë shndërruar në simbole, të cilat kujtojnë jetën e bukur në qytetet e Kosovës.

“Pranvera në Prishtinë”, “N’tren për Prizren”, “Mitrovicë, qyteti im”, “Gocë Pejane”, “Parisin me ma fal, Gjakovën nuk e ndërroj”, janë këngë që shoqërojnë mbrëmjet e bukura në qytetet e vendit.



“Pranvera në Prishtinë”, kolona zanore e këngëve të dashurisë

Pa dyshim, njëra nga këngët më të bukura për dashurinë lidhet me Prishtinën. E interpretuar nga Sabri Fejzullahu, kënga “Pranvera në Prishtinë” është njëra nga këngët më të popullarizuara për Prishtinën. Kjo këngë është një himn për Prishtinën dhe për dashurinë e madhe që njerëzit e kanë për këtë qytet. Ajo shpreh një ndjenjë nostalgjie, dashurie dhe shprese, duke përshtetur atmosferën e gjallë dhe bukurinë e Prishtinës në pranverë.

Në kontekstin historik, kënga ka një nëntekst patriotik, duke pasqyruar një ndjenjë lirie dhe krenarie për Kosovën. Pranvera në këtë rast mund të simbolizojë jo vetëm stinën e bukur, por edhe një rilindje shoqërore dhe kombëtare.



“Mitrovicë, qyteti im”, kënga simbol i Mitrovicës

Kënga “Mitrovicë, qyteti im” është kënduar për herë të parë nga grupi “Marigona”. Grupi i njohur interpretoi këngën, e cila u shndërrua në një himn të qytetit, duke shprehur dashurinë për vendlindjen dhe krenarinë për qytetin e Mitrovicës.

Kënga ka një mesazh emocional të fortë dhe ka ndikuar shumë tek ata që e kanë dëgjuar, duke i bërë të ndihen të lidhur ngushtë me qytetin e tyre dhe traditat e tij.

“N’tren për Prizren”, kënga që kujton dashurinë

E interpretuar nga grupi “Gjurmët”, kjo këngë ka një nuancë romantike dhe nostalgjike, duke përshkruar udhëtimin me tren drejt Prizrenit. Treni simbolizon një rrugëtim emocional dhe fizik, ndërsa Prizreni shfaqet si një vend i dashur dhe i mbushur me kujtime. Në tekst përmendet një dashuri që ndoshta ka mbetur në të kaluarën, por ende ndikon në shpirtin e personazhit kryesor.

Për shumë njerëz, kjo këngë zgjon kujtime nga koha kur trenat ishin një pjesë e rëndësishme e jetës në Kosovë, veçanërisht për ata që udhëtonin midis qyteteve për arsye pune, shkollimi apo dashurie. Prizreni, me historinë dhe bukurinë e tij, bëhet një simbol i nostalgjisë dhe emocioneve të thella.

“Goce Pejane”, kënga që kujton magjinë e Pejës

E krijuar nga Bedri Islami, kënga “Gocë Pejane” është njëra nga hitet më të mëdha për qytetin e Pejës. Është një këngë dashurie dhe krenarie, pasi një djalë shpreh admirimin dhe dashurinë për një vajzë nga Peja. Vajza pejane përshkruhet si e bukur dhe e veçantë, duke reflektuar imazhin e vajzës shqiptare me vlera dhe traditë. Në vargjet e saj, kënga shpreh një ndjenjë të thellë dashurie dhe respekti, ndërsa Peja simbolizon jo vetëm vendin e origjinës së vajzës, por edhe kulturën dhe historinë e pasur të asaj zone.

“Parisin me ma fal, Gjakovën nuk e ndërroj”, kënga shpreh ndjenjën e thellë për vendlindjen

E interpretuar nga këngëtari Shkëlzen Jetishi, kënga “Parisin me ma fal, Gjakovën nuk e ndërroj” është një thirrje krenarie për qytetin duke kujtuar dashurinë dhe përjetimet e këngëtarit në qytetin e tij të lindjes. Kënga shpreh një ndjenjë të thellë identiteti dhe dashurie për vendlindjen. Teksti i këngës thekson se Gjakova është atë e veçantë dhe e rëndësishme për këngëtarin, saqë ai do ta mbante gjithmonë si qytetin e tij të dashur, pa marrë parasysh mundësitë që ofron Parisi, apo çdo qytet tjetër i madh.

Ky mesazh tregon vlerësimin për qytetin, kulturën dhe traditat e Gjakovës, duke pasqyruar një ndjenjë të thellë patriotizmi dhe përkushtimi ndaj vendit të lindjes.

FROSTE^A TEA



**Frostea udhëton
bashkë me ty!**

MENAXHIMI I RRJETEVE SOCIALE

STRATEGJI & PLANIFIKIM
KRIJIM & PUBLIKIM PËRMBAJTJEJE
MENAXHIM & ANGAZHIM ME AUDIENCËN
REKLAMIM I TARGETUAR (ADS)
RAPORTIM & ANALIZË PERFORMANCE



www.pfp-ks.com

NA KONTAKTONI:

info@pfp-marketing.com

+383 43 899 331



- 290+ Kanale • 30+ Liga sportive • Internet deri në 500Mbps • Digitalb
- BigBrother VIP Kosova • BigBrother VIP Albania • Kanalet e Cinestar

Kujtesa jote,
përjetim i ri!

0800 400 40
www.kujtesa.com





BARIU GËNJESHTAR

Njëherë e një kohë, në një fshat të vogël, jetonte një bari që mbante dhinë dhe kosin. Ai ishte i njohur për gjithë fshatin për një zakon të keq që kishte: i pëlqente të bënte shaka dhe të thoshte gënjeshtra. Fshatarët e njihnin si "bariun gënjeshtar", sepse ai shpesh i bënte të tjerët të besonin në histori të çuditshme, për të qeshur më pas me ta.

Një ditë, bariu vendosi t'u bëjë një shaka të madhe fshatarëve. Ai hipi në mal, duke ulur dhitë dhe duke shikuar larg. Pastaj, bërtiti me të madhe: "Ndihmë! U sulmua kopeja ime nga ujku! Shpejt, vini dhe më ndihmoni!"

Fshatarët që ishin të afërm dhe punonin në ara u


shqetësuan dhe vrapuan me shpejtësi për t'i ardhur në ndihmë. Ata morën shkopinj dhe çarçafë dhe u ngjitën në mal. Por, kur mbërritën, panë që bariu qeshte dhe nuk kishte asnjë ujk në horizont.

"Bari, çfarë ka ndodhur?", pyeti njëri prej fshatarëve.

"Ah, më falni, isha vetëm duke u argëtuar", tha bariu. "Nuk kishte ujk, thjesht ju të gjithë u ngazëllyet shumë."

Fshatarët nuk u zemëruan shumë, por u kthyen dhe shkuan përsëri në punët e tyre.

Por, disa ditë më vonë, bariu përsëri e bëri të njëjtën gjë. "Shpejt, ndihmë! U sulmua kopeja ime nga ujku!", bërtiti ai nga malet. Fshatarët, të kujdesshëm



për herën e kaluar, prapë dolën me shpejtësi për ta ndihmuar. Po këtë herë, ata e panë që bariu ishte vetëm dhe qeshte përsëri.

"Po kjo është një tjetër gënjeshtëri", tha një fshatar. "Ti na mashtrove dy herë!"

Fshatarët filluan të humbnin besimin tek bariu. Disa nga ta i thonë: "Më mirë të mos i përgjigjemi thirrjes së tij, sepse po na gënjen."

Dhe ja, një ditë, kur bariu ishte në mal, një ujk vërtet erdhi dhe sulmoi kopenë e tij. Bariu bërtiti me të madhe, por këtë herë, fshatarët

nuk e besuan. Ata menduan se ishte një tjetër shaka dhe nuk u nxituan për të ndihmuar.

Ujku hëngri disa nga dhitë dhe bariu, i tronditur, më në fund kuptoi se pas gënjeshtreve të tij kishte ardhur një pasojë e hidhur.

Ai vrapoi për në fshat dhe kërkoi falje.

"Ju lutem, më falni! Nuk e dija se do të ndodhte kështu. Kur thashë se ujku më sulmoi, nuk keni besuar më", tha ai.

Fshatarët i përgjigjën: "Kur gënjen shpesh, edhe kur thua të vërtetën, askush nuk do të

të besojë." Dhe, kështu, bariu i kuptoi pasojat e gënjeshtreve të tij. Ai ka marrë një mësim të rëndësishëm dhe nuk e përsëriti më gabimin. Të gjithë e dinë tani se besimi është diçka shumë e rëndësishme dhe nuk mund të fitohet me gënjeshtër.

Mësimi i përrallës:

Gënjeshttrat mund të duken të padëmshme në moment, por ato e shkatërrojnë besimin e njerëzve dhe kur është vërtet e nevojshme të thuhet e vërteta, askush nuk do të të besojë.

DESIGN

REKLAMA 3D

Be Only Premium

DIGITAL PRINT

ADVERTISING

MATERIALE
PROMOCIONALE

BRANDING

LED SCREEN

 **ZHAKIADVERTISING**



+383 (0)38 60 60 68
+383 (0)45 87 87 87
+383 (0)45 97 97 97

Highway Prishtina - Shkup 6-th km
10000 Prishtinë, Kosovë
info@zhakiadvertising.com
www.zhakiadvertising.com

SkyShop



SkyShop Coffee&Tea



3 in 1 Nescafe Stick 20g
2 in 1 Nescafe Stick 20g
Nescafe Classic Stick 20g

2.50€

LOYD

Green Tea bag
Mixed Tea bag
Black Tea bag

2.50€



SkyShop Soft Drinks

Coca Cola 0.33l
Coca Cola ZERO 0.33l
Fanta Orange 0.33l
Fanta Exotic 0.33l
Schweppes 0.33l
Schweppes Tonic 0.33l
Sprite 0.33l
Multi Sola 0.5l
Ice Tea 0.33l

3.00€



RC Cola 0.33l
2.50€



Red Bull 250ml **4.00€**
GO+ 250ml **2.50€**
Veroni Active **3.00€**

Natryol Water-Miros 0.5l
Sparkling Water-Miros 0.33l

2.50€

Capri-Sun 0.33l

3.00€

Capri-Sun 0.20l

2.50€

Jaffa 0.25l

2.50€



SkyShop

Alcoholic Beverages

Ballantines Finest 0.05l
Absolut Vodka 0.05l
Chivas Regal 0.05l
Beefeater Gin 0.05l
Jack Daniel's 0.05l
Jägermeister 0.05l

5.00€



Cabernet Sauvignon 187ml
Chardonnay 187ml

5.00€

Peja Crudo 0.33l
Peja Pilsner 0.5l
Heineken 0.33l

4.00€



SkyShop Snacks



Skittles
m&m's 2.00€



Kinder Chocolate 50g
Kinder Joy 20g

2.00€



Bake Rolls 80g
Milka 80g

2.50€



Pringles Chips 40g

3.00€



Hey! Crax
Sedefi Hey
Stobi Flips

2.00€

Haribo
3.00€



Biskota Sempre



Kids
Sempre



Vipa Chips
Classic Mix
Crunch
Apple chips

2.50€

2.50€



Oreo 154g
Snickers 51g
Mars Bar 51g
Bounty Bar 51g
Twix Bar 51g
Kinder Bueno 43g
Kit Kat 42g

2.50€

SkyShop
Snacks



Musli
Pop Kek 45g
2.00€



7Days Croissant Double 60g
7Days Croissant Cacao 60g
2.50€

SkyShop Meals



200g

Cheese Sandwich

Sanduiq me djath

5.00€

200g
Dried Beef meat Sandwich
Sanduiq me përshutë viqi

5.00€



Soba Cup Noodles

5.00€



SkyShop Cigarette



MARLBORO GOLD +

29.00€



Winston BLUE +

24.00€



Camel FILTERS +

25.00€



MARLBORO RED +

29.00€



Terea Amber +

23.00€

Mirësevini në Hotel Bonita në Golem, Kavajë!

Hoteli me 5 yje ofron pishina të brendshme dhe të jashtme, SPA, qendër fitnesi, plazh privat dhe restorant me kuzhinë cilësore.

Destinacioni ideal për pushime të paharrueshme!

Për rezervimet tuaja kontaktoni në:

+355 69 822 9985

www.hotelbonita.al



POSSIBILITIES & PARTNERS

Empowering Your Brand
with Tailored Marketing Solutions

PRISTINA INTERNATIONAL AIRPORT ADEM JASHARI

**REKLAMO BIZNESIN
NË AEROPORTIN E PRISHTINËS**



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGIJE

**Transform your
confidence with
our expert care!**

We specialize in advanced dentistry and precision hair transplant solutions, combining cutting-edge technology with personalized treatments. From radiant smiles to revitalized hair, we're here to help you look and feel as best as possible.

Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI



Part of DENTFIX GROUP



f @dentfix_ks

+383 44 22 55 34

www.dentfix-ks.com

Ahmet Krasniqi Str. No 137,
Pristina, Kosovo



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC